

## GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS

P. nr. 14/2013

12 Shtator 2013

### NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE E MITROVICËS**, në trupin gjykues të përberë nga Gjyqtarja e EULEX-it Katja Dominik në cilësi të kryetares së trupit Gjykues dhe Gjyqtari i EULEX-it Dariusz Sielicki dhe Gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX-it John Gayer si Procesmbajtës në lëndën penale ndaj:

**S.G.** , i biri i T.G. , i lindur në fshatin (në tekstin e mëtejme: ), komuna (në tekstin e mëtejme ), data e lindjes . Me banim në , kati i . Shkollën e lartë të kryer dhe i punëtor i .

**Rr.G.** , i biri i S.G. , i lindur në fshatin , komuna , data e lindjes . Me banim në komunën e , Rruga , Hyrja kati i , Apt. nr. . Posedon diplomë të ekonomikut dhe është zyrtar në .

**H.G.** , i biri i S. G. i lindur në fshatin , komuna , data e lindjes . Me banim në fshatin , në komunën e . Shkollën e lartë të kryer dhe është në .

*Të gjithë të akuzuar me Aktakuzën e Prokurorit Publik PP. 81/2012 të datës 11 Dhjetor 2012 dhe të ndryshuar më 17 Janar 2013 dhe paraqitur në Shkrimoren e Gjykatës së Qarkut të Mitrovicës më 12 Dhjetor 2012 për dy pika të aktakuzës për **krime lufte kundër popullatës civile** nga Nenet 22 dhe 142 të Ligjit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (LP RSFJ) që reflektohet në Nenet 31 dhe 152 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRP), në shkelje të Nenit 3 i përbashkët në katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 dhe të Nenit 4 dhe 5 (1) të Protokollit II të datës 8 Qershor 1977, shtesë e Konventave të Gjenevës,*

*Dhe **B.Sh.** , i biri i M. Sh. , i lindur në fshatin , data e lindjes . Rezident i Komunës së . Është .*

*I Akuzuar me Aktakuzën e ndryshuar të lartcekur të Prokurorit Publik PP. 81/2012 për një pikë të aktakuzës për **Dhënia e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale** nga Nenet 305 Para. (1) dhe (2) i Kodit Penal të Kosovës (KPK), që tani inkriminohet nga Neni 388 Para. (1) dhe (2) i Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).*

Pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit gjyqësor, pjesërisht e hapur për publik, më 11 dhe 14 Qershor; 1, 2, 5, 12 dhe 19 Korrik; 12, 13, 14, 15 Gusht; dhe 4, 6, 9 dhe shpalljes së verdiktit më 12 Shtator 2013; gjithnjë në prani të të Pandehurve **S. G.** , **Rr. G.** , **H. G.** dhe **Dr B.Sh.** ; Avokatëve të tyre Mbrojtës Tahir Rrecaj, Mahmut Halimi, Fatbardh Makolli, dhe Gani Rexha apo të zëvendësuesve

të tyre; Palëve të Dëmtuara I.V. , M. V. të pranishëm më 14 Qershor 2013, dhe Prokurorit Publik të EULEX-it apo zëvendësit të tij, pas këshillimit dhe votimit të trupit gjykues të mbajtur 11 Shtator 2013, sipas Nenit 359 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPP), shpallur publikisht dhe në prani të të pandehurve, Avokatëve të tyre Mbrojtës, dhe Prokurorit Publik të EULEX-it Maurizio Salustro lëshon këtë:

## **AKTGJYKIM**

I. Të Akuzuarit **S.G.** , **Rr. G.** dhe **H. G.** me të dhëna personale si më lartë,  
Të gjithë për Pikën Nr. 1 të Aktakuzës shpallen

### **FAJTOR**

Në rastin e G. B. dhe

Të gjithë shpallen

### **TË PAFAJSHËM**

Në rastin e V.B.

Sepse është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më gjersa akoma po zhvillohej një konflikt i armatosur ndërmjet forcave të armatosura të rregullta dhe të parregullta të Armatës së ish Jugosllavisë dhe Serbisë në njërën anë dhe të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në anën tjetër në territorin e Kosovës, të tre të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** në cilësinë e tyre si UÇK kanë vrarë G. B. në . Ai ishte civil.

Më , forcat e armatës së ish Jugosllavisë dhe Serbisë po tërhiqeshin nga regjioni i dhe KFOR-i dhe UÇK-ja kishin marrë kontrollin në . Në qendër të qytetit të popullata Shqiptare në masë të madhe po festonte këtë ngjarje me të ashtuquajturat “ shtënie me armë për gëzim”. Në pasditen e asaj dite, pas orës , viktimat G. dhe V.B. ishin gjithashtu në qendër të qytetit të te udhëkryqi afër qendrës mjekësore dhe ndërtesës së gjykatës. Një person i panjohur ka shtënë me armë zjarri dhe ka qëlluar të dy vëllezërit B. . V. ishte vrarë, dhe G. ishte plagosur. Nuk është vërtetuar se të tre të Pandehurit **G.** një nga një, bashkë apo në kuptim të një plani të përbashkët kishin shtënë me armë. Megjithatë, ata kishin qëndruar afër viktimave kur ishte shtënë në ta.

Pak kohë pas të shtënave të udhëkryqi i përshkruar më lartë, i plagosuri G. B. ka arritur në qendrën mjekësore të që gjendet metra nga vendi ku ishin qëlluar vëllezërit B. . Qendra mjekësore shërbente si spital në atë kohë. G. ishte vendosur në një shtrat në dhomën e . Persona të panjohur gjithashtu e kishin transportuar vëllain e tij të vdekur V. në qendrën mjekësore ku ishte vendosur afër G. sepse aty nuk kishte morg.

**Sabit** , **Rr.** dhe **H. G.** kishin kuptuar se G. B. vetëm ishte plagosur. Ata kishin vendosur t'i shkojnë prapë në qendrën mjekësore dhe ta vrasin në një veprim të përbashkët. Motivacioni i tyre ka qenë pretendimi, miratuar nga UÇK-ja, se të dy vëllezërit B. kishin bashkëpunuar me Serbët, dhe prandaj duheshin vrarë për atë që kishin vepruar ashtu. Në ekzekutimin e këtij plani të përbashkët, aty kishin hyrë në dhomën ku ishte G. dhe njëri nga ta kishte shtënë për vdekje në të me armë zjarri , të cilën gjë të gjithë e kishin për qëllim. Në këtë dhomë kishte qenë edhe i Pandehuri **Dr. Sh. . S. , Rr.** dhe **H. G.** pastaj kisin dalë nga qendra mjekësore.

Të Pandehurit kanë vepruar në shkelje të ligjit të aplikueshëm ndërkombëtar dhe vendor në atë kohë.

Kështu që, të Pandehurit **S.G. , Rr.G.** dhe **H.G.** kanë kryer dhe janë të gjithë penalisht përgjegjës në rastin e Gani Berishës, por jo në rastin e Vehbi Berishës për veprën penale

*Krime Luftë kundër popullatës civile të kryer në bashkëkryerje, nga Nenet 22 dhe 142 të LPRSFJ, tani nga Nenet 31 dhe 152(2.1) e KPRK, në shkelje të Nenit 3 të përbashkët në katër Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 dhe Nenit 4 të Protokollit II të datës 8 Qershor 1977, shtesë të Konventës së Gjenevës.*

II. Të Akuzuarit **S.G. , Rr.G.** dhe **H.G.** të gjithë për Pikën Nr. 2 të Aktakuzës shpallen

### TË PAFAJSHËM

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar se gjatë një kohe të konfliktit të armatosur në Kosovë, të Pandehurit në cilësi të pjesëtarëve të UÇK-së vetëm apo në bashkëkryerje me njëri tjetrin, me qëllim apo nga pakujdesia, kanë plagosur me të shtëna të armëve të zjarrit në pasditen e vonë të datës në qendër të qytetit të palët e Dëmtuara I.V. dhe M.V. të cilët ishin pjesëtar joaktiv të UÇK-së në atë kohë.

I.V. dhe M.V. më ishin në qendër të qytetit të te udhëkryqi afër G. dhe V.B. kur ata – V. – ishin qëlluar nga plumbat e rastit në të njëjtën kohë me G. dhe V. I.V. ishte plagosur rëndë në bark dhe M.V. kishte marrë plagë në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë.

Duke pranuar argumentet nga Pika 1 lidhur me të shtënat e vëllezërve B. në rrugë, nuk është vërtetuar se kishte qenë një nga të Pandehurit **G.** , qoftë vetëm, bashkërisht apo si pjesë e planit të përbashkët të tyre përgjegjës i drejtpërdrejtë apo i tërthorë për të shtënat në vëllezërit V. në rrugë. Lëndimet që i kishin pësuar vëllezërit V. nuk mund të lidhen përtej dyshimit të arsyeshëm me ndonjë aktivitet të **S. , Rr.** apo **H. G.** .

Prandaj, të Pandehurit **S. G. , Rr. G.** dhe **H.G.** asnjëri nuk ka kryer dhe nuk është penalisht përgjegjës për veprën penale

*Krime Luftë kundër popullatës civile të kryer në bashkëkryerje, nga Nenet 22 dhe 142 të LPRSFJ, tani nga Nenet 31 dhe 152 paragrafët (1) dhe (2.1) e KPRK, në shkelje të Nenit 3 të përbashkët në katër*

*Konventat e Gjenevës të datës 12 Gusht 1949 dhe Neni 4 të Protokollit II të datës 8 Qershor 1977, shtesë të Konventës së Gjenevës*

III. I Akuzuari **Dr B. Sh.**, me të dhëna si më lartë,  
shpallet

### **I PAFAJSHËM**

Sepse nuk është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se më Pjesëtarët e UÇK-së **S.G.**, **Rr.G.** dhe **H.G.** gjatë një konflikti të brendshëm të armatosur në Kosovë kanë vrarë bashkëpunëtorin e pretenduar G.B. në qendrën mjekësore në në prani të të pandehurit **Dr. Sh.**, dhe është vërtetuar se **Dr. Sh.** me vetëdije i ka dhënë një deklaratë të pavërtetë Prokurorit Publik më duke thënë se nuk kishte qenë prezent në dhomë kur kishte ndodhur vrasja. Megjithatë, veprimi i tij nuk përmban karakteristikat e nevojshme të veprës penale për të cilën akuzohet, përkatësisht nga Neni 305 KPK, apo të ndonjë vepre tjetër penale sepse ai nuk ka ndihmuar në shmangien e zbulimit të kryerësve të lartcekur të vrasjes.

Prandaj, i Pandehuri **Dr B. Sh.** nuk ka kryer dhe nuk është penalisht përgjegjës për veprën penale

*Ofrimi i ndihmës kryerësve pas kryerjes se veprave penale, nga Neni 305 paragrafët (1) dhe(2) KPK.*

IV. I Pandehuri **S. G.**

### **DËNOHET**

me dymbëdhjetë (12 ) vjet burgim për Pikën 1 – krime lufte kundër popullatës civile - sa i përket Gani Berishës,

dhe për Pikën 1 sa i përket Vehbi Berishës dhe për Pikën 2 - krime lufte kundër popullatës civile

### **LIROHET.**

V. I Pandehuri **Rr. G.**

### **DËNOHET**

me dymbëdhjetë (12 ) vjet burgim për Pikën 1 – krime lufte kundër popullatës civile - sa i përket G. B.

dhe për Pikën 1 sa i përket V.B. dhe për Pikën 2 - krime lufte kundër popullatës civile

**LIROHET.**

VI. I Pandehuri **H.G.**

**DËNOHET**

me dymbëdhjetë (12 ) vjet burgim për Pikën 1 – krime lufte kundër popullatës civile - sa i përket G.B. ,

dhe për Pikën 1 sa i përket V. B. dhe për Pikën 2 - krime lufte kundër popullatës civile

**LIROHET.**

VII. I Pandehuri **Dr B. Sh.**

**LIROHET**

Nga akuza për Ofrimin e ndihmës kryerësve pas kryerjes së veprave penale nga Neni 305 Para. (1) dhe (2) e KPK.

VIII.

Të Pandehurit **S.G.** , **Rr.G.** dhe **H.G.** secili prej tyre do të kompensojë njëqind e pesëdhjetë (150) Euro si pjesë e shpenzimeve të procedurës penale, derisa lirohen nga detyrimi i kompensimit të pjesës tjetër të shpenzimeve sipas Nenit 453 Para. (1) dhe (4) të KPP. Sipas Nenit 454 të KPP, shpenzimet e procedurës penale sa i përket të Pandehurit **Dr Sh.** do të paguhen nga burimet buxhetore.

IX.

Koha që të Pandehurit **S.G.** , **Rr.G.** dhe **H.G.** kanë kaluar në arrest shtëpiak dhe në paraburgim që nga data do të llogaritet në shumën e dënimit sipas Nenit 50 Para. (1) të LP RSFJ.

**ARSYETIM****A. HISTORIA PROCEDURALE***I. Historia Procedurale*

Më Prokurori i EULEX-it nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës ka inicuar hetimet ndaj **S.G.** , **Rr.G.** dhe **H.G.** paraqitur në Gjykatën e atëhershme të Qarkut të Mitrovicës më . Me një aktvendim të datës hetimet janë zgjeruar duke përfshirë edhe **Dr. B.Sh.** për veprën e akuzuar. Me një Aktvendim të veçantë të

datës janë zgjeruar hetimet ndaj **S.G.**, **Rr.G.** dhe **H.G.** ku përfshihet një pikë e dytë e veprës krime lufte kundër popullatës civile. Të dy Aktvendimet për zgjerimin e hetimeve janë paraqitur më .

Më 12 Dhjetor 2012 Prokurori Special ka paraqitur aktakuzën PP.no 81/2012 të datës 11 Dhjetor 2012 dhe e ka ndryshuar më 17 Janar 2013 me të cilën akuzohen të Pandehurit ashtu si ceket në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shqyrtimi gjyqësor është mbajtur më 11 dhe 14 Qershor; 1, 2, 12 dhe 19 Korrik; 12 deri 15 Gusht; dhe 4, 6 dhe 9 Shtator 2013 dhe aktgjykimi është shpallur më 12 Shtator 2013.

## *II. Kompetenca e Gjykatës*

Veprat penale bien në kompetencë lëndore dhe territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës dhe në kompetencë të gjyqtarëve të EULEX-it.

Vepra krime lufte kundër popullatës civile ka të bëjë me shkelje të rëndë të ligjeve dhe zakoneve të aplikueshme në kohën e një konflikti të armatosur jo-ndërkombëtar dhe është Krim i Rëndë siç përcaktohet me Nenin 22(1.29) të KPK dhe Nenin 15 (1.2) të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 2010/03-L199 (LGJ)) që e vendos atë nën juridiksionin e vetëm të departamentit të Krimeve të Rënda. Kjo vlen edhe në rastin e të Pandehurit **B.Sh.** i cili akuzohet se ka qenë bashkëfajtor me kryerësit e krimeve të rënda. Neni 35.4 i KPK lejon që lënda e tij të bashkohet me procedurat tjerat dhe që ait ë gjykohet nga Gjykata e njëjtë.

Me që vepra është kryer në Komunën e , ajo bie në kompetencë territoriale të Gjykatës Themelore të Mitrovicës sipas Nenit 9(2.9) të LGJ.

Lënda u është caktuar gjyqtarëve të EULEX-it në përputhje me Nenin 3.1 të Ligjit mbi Kompetencat, Përzgjedhjen dhe Caktimin e Lëndëve Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053) sepse është hetuar dhe ndjekur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës.

## **B. Provat**

Aktgjykimi bazohet në të gjitha provat e pranueshme pas zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor:

I. Gjatë shqyrtimit gjyqësor dëshmitarët dhe ekspertët në vijim kanë dhënë deklarata ( sipas renditjes së paraqitjes së tyre në shqyrtim gjyqësor):

1. I.V. më ,
2. M.V. më ,
3. J. B. më and ,
4. Dr B. M. më ,
5. E.B. më ,
6. B. Z. më ,
7. N. B. më ,
8. A. B. më ,
9. Z. A. më ,

10. H.M. më ,  
 11. H.B. më ,  
 12. F. G. më ,  
 13. H.G. më ,  
 14. A.G. më ,  
 15. Dr C.B. më ,  
 16. J. R. më ,  
 17. B.B. më ,  
 18. F. O. më ,  
 19. X.J. më ,  
 20. Q.A. më ,  
 21. H. K. më ,  
 22. S.I. më ,  
 23. L.G. më ,  
 24. K.Xh.B. më ,  
 25. B.B. më ,  
 26. B.B. më ,  
 27. F.H. më , and  
 28. H.R. më .

II. Me pëlqimin e palëve dhe në përputhje me Nenin 338(1.3) të KPP deklaratat e dëshmitarëve në vijim konsiderohen të lexuara në procesverbal si prova të pranueshme:

**Grupi a): Dëshmitarët e dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor (sipas alfabetit)**

1. Deklarata e A.B. e datës ,  
 2. Deklarata e A. G. e datës ,  
 3. Deklarata e Dr B.M. e datës ,  
 4. Deklarata e B.B. e datës ,  
 5. Deklarata e B.B. e datës ,  
 6. Deklarata e B.B. e datës ,  
 7. Deklarata e B.Z. e datës ,  
 8. Deklarata e E.B. e datës ,  
 9. Deklarata e F.O. e datës ,  
 10. Deklarata e F.H. e datës ,  
 11. Deklarata e F.G. e datës ,  
 12. Deklaratat e H.G. të datës dhe ,  
 13. Deklarata e H.B. e datës ,  
 14. Deklarata e H.M. e datës ,  
 15. Deklarata e H.R. e datës ,  
 16. Deklarata e I.V. e datës ,  
 17. Deklaratat e J. B. të datës , , , dhe  
 ,  
 18. Deklarata e J.R. e datës ,  
 19. Deklarata e L.G. e datës ,  
 20. Deklarata e K.X. B.e datës ,  
 21. Deklarata e M.V. e datës ,  
 22. Deklarata e N.B.e datës ,  
 23. Deklarata e Q.A. e datës ,  
 24. Deklarata e S.I. e datës ,  
 25. Deklarata e Xh.J. e datës ,

26. Deklarata e M.H. e datës ; and  
 27. Deklarata e S.R. B. e datës ;

**Grupi b): Dëshmitarët që nuk janë dëgjuar gjatë shqyrtimit gjyqësor (sipas alfabetit)**

1. Deklarata e A.B. H. e datës ,
2. Deklarata e A.L. e datës ,
3. Deklarata e A.G. (lindur më: ) e datës ,
4. Deklarata e Dr B. G. e datës ,
5. Deklarata e G. G. e datës ,
6. Deklarata e H. G. e datës ,
7. Deklarata e M. G. e datës ,
8. Deklarata e N. R. e datës ,
9. Deklarata e S. G. e datës ,
10. Deklarata e Sh.B. G. e datës ,
11. Deklarata e Z. D. e datës ,
12. Deklarata e Z. T. e datës ;

**Grupi c): Deklaratat e të Pandehurve (sipas renditjes së aktakuzës)**

1. Deklarata e **S.G.** e datës ,
2. Deklarata e **Rr. G.** e datës ,
3. Deklaratat e **H. G.** të datës dhe ,
4. Deklaratat e **Dr B. Sh.** të datës dhe .

**III. Gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor në procesverbal janë evidentuar këto dokumente:**

1. Raporti i Zyrës së Ekzaminuesit Mjekësor të DML (Dr C.B. ) lidhur me ekzaminimin e Palës së Dëmtuar M.V. me shtojca,
2. Raporti i Zyrës së Ekzaminuesit Mjekësor të DML (Dr C.B. ) lidhur me ekzaminimin e Palës së Dëmtuar I.V. me shtojca,
3. Tri foto të njësisë së EULEX- ĒCIU të të pandehurve **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** bashkangjitur raportit policor të datës ,
4. Certifikata e vdekjes së G. dhe V.B. ,
5. Fletët e punës së mjekësore në për datën deri dhe regjistrat e kujdestarisë për dhe dorëzuar nga i Pandehuri **Sh.** ,
6. Harta e KFOR-it për regjionin e dhe (të paraqitura sit ë dhëna sipas *detyrës zyrtare*),
7. Fleta lidhur me kohën e perëndimit të diellit në në vitin dhe ,
8. Harta e fshatit - e printuar nga faqja Google, dhe
9. Gazeta EXPRESS e datës (Artikulli për J.B. ).

IV. Gjykata me aktvendimet e saj të datës dhe ka urdhëruar masat mbrojtëse në rastet e dëshmitarëve J. , B. dhe B.B. . Gjykata u referohet këtyre aktvendimeve.

**V. Gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor janë bërë këto propozime:**

1. Më , Prokurori ka propozuar B. dhe B.B. si dëshmitar kundërshtues të dëshmitarit të mbrojtjes H.B. i cili kishte dëshmuar se kishte qenë në më . Kjo është kundërshtuar nga mbi bazën se dëshmitarët e



propozuar kanë qenë në më dhe nuk kanë qenë dëshmitarë të ngjarjeve qoftë në qoftë në . Gjkata e ka aprovuar kërkesën meqë dëshmitarët pohonin se dëshmitari i mbrojtjes ishte në më . Gjkata i referohet aktvendimit siç jepet në procesverbalin e datës .

2. Mbrojtja ka bërë një propozim për ta thirrur H.K. si dëshmitar. Ai kishte qenë në më . Prokuroria ka kundërshtuar dëshmitarin se ishte i panevojshëm duke pasur parasysh numrin e dëshmitarëve lidhur me të cilët tashmë kishin dëshmuar apo duhej të dëshmonin. Gjkata e ka aprovuar propozimin pasi që H.K. ishte përmendur nga një numër dëshmitarësh tjerë që ishin dëgjuar nga Gjkata.

3. Më , Mbrojtja ka kërkuar zbulimin e çfarëdo raporti të KFOR-it nga trupat në më . Ata nuk ishin në dijeni nëse ekziston një raport i tillë i KFOR-it. Ata vetë nuk kanë bërë ndonjë kërkim të KFOR-i, as në fazën paraprake as në fazën e shqyrtimit gjyqësor. Propozimi nuk është kundërshtuar nga Prokuroria e cila nuk ka qenë në kontroll apo posedim të ndonjë raporti të KFOR-it. Gjkata ka refuzuar propozimin sipas detyrës zyrtare. Janë bërë kërkime dhe kontrollim i arshivës së KFOR-it në Kosovë dhe arkiva e Ministrisë së Drejtësisë së në ka kthyer rezultat negativ. Për këtë Gjkata i referohet shpjegimit të Kryetarit të Trupit Gjyqësor në seancën e shqyrtimit gjyqësor më .

4. Më Prokuroria ka kërkuar të pranohen këto prova dokumentuese: një kopje e gazetës EXPRESS e datës ; një printim nga faqja e internetit Google Maps që tregon distancën ndërmjet dhe në vij të drejtë; koha e perëndimit të diellit për regionin e për vitin dhe ; dhe deklaratat policore të M.H. të datës dhe të S.R.B. të datës . Mbrojtja nuk ka kundërshtuar përfshirjen e deklaratave të fundit dhe të të kohës së perëndimit të diellit apo deklaratave për të cilat ishin pajtuar për t'u lexuar. Ata kanë argumentuar se gazeta EXPRESS nuk ishte e nevojshme. Prokuroria ka argumentuar se ajo përmban një artikull ku atakohet përfshirja e J. B. në procedurë. Gjkata ka konsideruar se ajo ishte e pranueshme. Mbrojtja gjithashtu ka theksuar se printimi i hartës nga faqja Google nuk ka paraqitur distancën e asnjë këmbësoresh apo . Gjithashtu, printimi nuk ka treguar distancën ndërmjet pjesëve të ndryshme të dhe . Propozimi i Prokurorisë është aprovuar. Gjkata vuri re dhe u pajtua me paralajmërimet e vendosura në fletën e shtypur të hartës nga faqja Google.

5. *Sipas detyrës zyrtare* Gjkata ka paraqitur një hartë të KFOR-it për rajonin ku shihet topografia dhe distanca ndërmjet dhe . Asnjë palë nuk ka ngritur ndonjë kundërshtim.

6. I Pandehuri **Dr.Sh.** ka paraqitur një propozim për të përfshirë fletët e punës për datën deri më dhe të dhënat mbi kujdestarit për muajin dhe nga qendra mjekësore e . Ato tregojnë personelin që kishte punuar dhe kishte qenë kujdestar gjatë kësaj periudhe duke përfshirë datën . Nuk pati ndonjë kundërshtim dhe dokumentet u pranuan.

### ***C. Gjetjet e Fakteve dhe Analiza e Provave***

I. Pas fazës së provave të shqyrtimit gjyqësor, Gjkata mund të vërtetojë këto fakte:

Në vitet 1998/99 Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UCK/KLA) ka luftuar kundër forcave të armatosura të Republikës Federative të Jugosllavisë së atëhershme dhe të Republikës së Serbisë për ta marrë kontrollin mbi territorin e Kosovës e cila në atë kohë ishte Krahinë Autonome në Republikën Federative të Jugosllavisë dhe de-facto nën kontrollin e Republikës së Serbisë. UÇK-ja ka filluar në mënyrë efektive si organizatë e nëntokës dhe gjatë rrjedhës së konfliktit ka fituar një strukturë të konsiderueshme organizative. Pjesëtarët e UÇK-së mbanin lloje të ndryshme të uniformave përfshirë edhe uniformat kamuflazhe. Sipas së ashtuquajturës Marrëveshjeje e Kumanovës (Marrëveshja Teknike Ushtarake ndërmjet Forcës Ndërkombëtare të Sigurisë ["KFOR"] dhe të Qeverive të Republikës Federative të Jugosllavisë dhe Republikës së Serbisë) e nënshkruar më 09 Qershor 1999, forcat ushtarake të Jugosllavisë dhe Serbisë kishin filluar tërheqjen nga Kosova. Kjo marrëveshje parashihte tërheqjen e tyre në faza brenda 11 ditësh pas nënshkrimit të marrëveshjes. Tërheqja ka përfunduar më 21 Qershor 1999 kur trupat e fundit të ushtrisë Jugosllave dhe Serbe e kanë lëshuar territorin e Kosovës.

Më \_\_\_\_\_, forcat Jugosllave dhe Serbe kishin lëshuar regjionin e \_\_\_\_\_; trupat e KFOR-it dhe të UÇK-së morën kontrollin. KFOR-i kishte hyrë në Komunën e \_\_\_\_\_ dhe gjithashtu kishte kaluar nëpër fshatin \_\_\_\_\_. Fshati gjendet rreth \_\_\_\_\_ kilometra në vij të drejtë në drejtim të veriut nga \_\_\_\_\_; komuna e \_\_\_\_\_ mund të arrihet ose përmes një rruge rreth \_\_\_\_\_ km ose përmes një rruge më të shkurtër këmbësorësh. Fshati \_\_\_\_\_ gjendet në perëndim të \_\_\_\_\_; pjesët lindore të tij gjinden në distancë prej \_\_\_\_\_ - km nga \_\_\_\_\_, gjerësia pjesët perëndimore arrijnë në distancë jo më shumë se \_\_\_\_\_ km nga \_\_\_\_\_.

Pasi forcat Jugosllave dhe Serbe kishin lëshuar \_\_\_\_\_ në mëngjesin e datës \_\_\_\_\_, popullata shqiptare e Kosovës ishin entuziazuar për këtë ngjarje të cilën ata e konsideruan si çlirim, ndërsa qytetarët Serb të Kosovës kishin lëshuar qytetin. Populli po festonte me shtënie me armë në rrugë në shenjë gëzimi, dhe qytetarët nga fshatrat e afërm si \_\_\_\_\_, kishin ardhur në qytet duke ecur në këmbë apo me traktor për të festuar përfundimin e luftës. Fshatarët nga \_\_\_\_\_, përfshirë familjen B. \_\_\_\_\_, gjithashtu mësuan se lufta kishte përfunduar kur kishin vërejtur helikopterët dhe automjetet e KFOR-it që po kalonin aty pari. Dëshmitari J.B. \_\_\_\_\_ dhe vëllai i tij i ndjerë \_\_\_\_\_ Xh. B. gjithashtu kishin vendosur që ta linin fshatin dhe të shkonin në \_\_\_\_\_.

J. \_\_\_\_\_ dhe Xh.B. \_\_\_\_\_ ishin nisur rrugës së shkurtër të këmbësorëve dhe së pari ishin ndalë në një vend ku vëllezërit kishin shpresuar ta gjenin një traktor që më parë iu kishte vjedhur Xh. \_\_\_\_\_. Kur nuk e kishin gjetur traktorin, ata kishin vazhduar rrugën. Afër vendit të quajtur \_\_\_\_\_ ata kishin takuar një traktor me njerëz në rimorkio të cilët gjithashtu kishin vendosur të shkonin në \_\_\_\_\_. Vëllezërit B. \_\_\_\_\_ ishin ftuar që t'i bashkohen këtij udhëtimi, por Xh. \_\_\_\_\_ kishte refuzuar dhe që të dytë kishin vazhduar ecjen në këmbë.

Atyre iu deshën së pakut \_\_\_\_\_ orë e gjysmë që të arrinin në \_\_\_\_\_. Kur kanë arritur, kanë ecur nëpër rrugë. J. \_\_\_\_\_ ishte i interesuar ta uzurponte një banesë që ishte braktisur nga një Serb i cili kishte shkuar nga aty. Kur kishte arritur në atë vend, kishte takuar Dëshmitarin Z.A. \_\_\_\_\_ i cili gjithashtu synonte ta uzurponte atë. J. \_\_\_\_\_ e kishte kuptuar se ishte vonuar tepër dhe ishte kthyer në rrugë ku ende po vazhdonin festimet pasdite.

Të Pandehurit S. \_\_\_\_\_, Rr. \_\_\_\_\_ dhe H. G. \_\_\_\_\_ kishin qenë në fshatin e tyre \_\_\_\_\_ në mëngjesin e datës \_\_\_\_\_. S. \_\_\_\_\_ po meremetonte një dhomë në shtëpinë e tij në \_\_\_\_\_ për \_\_\_\_\_

anëtarët e familjes për të cilët priste se do të ktheheshin pas luftës. **Rr.G.** po rrinte në një shtëpi në të epërme atë mëngjes. Nuk ishte e qartë se ku ishte **H.G.** në mëngjesin e asaj dite. Në një moment të caktuar gjatë ditës të tre të Pandehurit **G.** kishin vendosur të shkonin në . Nuk është mundur të vërtetohet në fazën e provave të shqyrtimit gjyqësor se kur kishin vendosur ata të vepronin ashtu dhe nëse kishin shkuar bashkë apo ndaras. Sidoqoftë, ishte e qartë se në një moment pas orës të pas ditës që të tretë ishin të pranishëm në udhëkryqin e qendrës së qytetit në . Ata ishin të armatosur me pushkë Kalashnikov dhe veshur kishin uniforma të UÇK-së. Të tre të Pandehurit **G.** ishin pjesëtarë të brigadës së UÇK në atë kohë.

Pas orës por para se të errësohej, viktimat **V.** dhe **G.B.** dhe Palët e dëmtuara **I.** dhe **M.V.** kishin arritur në udhëkryq në qendrën e qytetit në . **G.** dhe **V. B.** – që njihen edhe si ‘ ’ sipas fshatit prej nga kishin ardhur – ishin civilë dhe nuk kishin të veshur uniforma. Në të katër viktimat ishte shtënë në udhëkryq. **V.B.** kishte vdekur; **G.B.** ishte plagosur. **I.** dhe **M.V.** kishin qenë rreth m larg nga **B.** . **M.** ishte plagosur në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë dhe **I.** ishte qëlluar në regjionin e abdomenit. **I.** kishte marrë ndihmën e parë nga ushtarët e KFOR-it që po qëndronin aty dhe nga Dëshmitari **Dr. M.** . Nuk është mundur të vërtetohet përtej dyshimit të arsyeshëm se ishte një apo më shumë nga të Pandehurit që kishte shtënë në **V.** dhe **G.B.** dhe e kishte vrarë **V.** apo se kishte plan për ta bërë atë, apo nëse ishte një apo më shumë nga të Pandehurit që kishte shkrepur plumbat të cilët faktikisht kishin plagosur vëllezërit **I.** dhe **M.** .

Viktimat **V.** dhe **G.B.** pastaj kanë arritur te qendra mjekësore e aty afër, së pari **G.** dhe pastaj **V.** . Nuk është mundur të vërtetohet nëse **G.** kishte ecur deri te qendra mjekësore apo nëse ai dhe **V.** ishin transportuar dhe nëse është ashtu me çfarë mjeti dhe nga kush. Megjithatë, shqyrtimi gjyqësor ka vërtetuar se ai kishte qenë gjallë kur kishte arritur aty, dhe kishte marrë një infuzion mjekësor. Në kuadër të qendrës mjekësore, vëllezërit **B.** ishin vendosur në shtretër njëri pran tjetrit në dhomën e emergjencës në katin përdhes. **V.** ishte vendosur pranë **G.** sepse kishte hapësirë dhe se qendra mjekësore nuk kishte morg.

**S.** , **H.** dhe **Rr.G.** kishin kuptuar se **G.B.** nuk kishte vdekur. Ata kishin vendosur të shkonin në qendrën mjekësore për ta vrarë **G.B.** . Ata donin që ai të vdiste për shkak të pretendimit se kishte bashkëpunuar me Serb. Të tre të Pandehurit kishin hyrë në dhomë, dhe së pakut njëri nga ta kishte shtënë me Kalashnikov ( ) në **G.** . **G.B.** kishte vdekur gjë të cilën të gjithë të Pandehurit e kishin dëshiruar të ndodhte. Pastaj ata kishin dalë nga dhoma e emergjencës dhe nga qendra mjekësore. I Pandehuri **Dr.Sh.** i cili ishte brenda në dhomën e e kishte parë vrasjen e **G.B.** . Ai ishte në gjendje shoku dhe frike.

Të ndjerët **G.** dhe **V.** më vonë ishin zhvendosur nga qendra mjekësore në spitalin e pediatriisë përball qendrës mjekësore ku ruheshin kufomat e tyre. Dëshmitarja **K.Xh.B.** , e veja e të ndjerit **V.** , kishte i identifikuar ata aty dhe i kishte sjellë në shtëpi për t'i varrosur. Nuk është bërë as ekzaminim mjekësor as autopsi. Asnjë anëtarë i familjes **B.** as ndonjë qytetar tjetër nuk është paraqitur vullnetarisht për të dhënë deklaratë lidhur me atë çka kanë parë, Incidenti nuk është hetuar deri në të vitit , kur organet hetimore të EULEX-it e kishin zbuluar rastin.

Kjo ka ndodhur kur më , dëshmitari **J.B.** i kishte dhënë një deklaratë Prokurorit Special gjatë hetimit e një rasti tjetër të krimeve të luftës. Gjatë kësaj interviste,

Prokurori e kishte pyetur se a dinte ai për krime lufte që ishin kryer në Kosovë. Dëshmitari J. kishte ofruar vullnetarisht vërtetimet e tij lidhur me vrasjet e G. dhe V.B. dhe PSRK e EULEX-it kishte filluar hetimet ndaj të Pandehurve S. , Rr. dhe H. G. Dëshmitari J.B. dhe të bijtë e tij B. dhe B.B. aktualisht janë nën programin e EULEX-it për mbrojtjen e dëshmitarëve. Dëshmitari N.B. ,a, nip i të ndjerëve G. dhe V. , është intervistuar në dhe ai e ka statusin e refugjatit në . Pala e Dëmtuar K.Xh.B. ka dhënë deklaratë në të vitit . Prokurori Special ka paraqitur një kërkesë për t'i vënë të Pandehurit G. nën masën e paraburgimit të cilën kërkesë e ka aprovuar Gjyqtari i Procedurës Paraprake me një Aktvendim të datës . I Pandehuri **Dr. Sh.** është intervistuar së pari si dëshmitar më nga Prokurori. Ai ka dhënë deklaratë se kishte qenë në qendrën mjekësore më por kishte qenë në një dhomë tjetër, në repartin e . Ai ka deklaruar se nuk kishte parë ndonjë vrasje që ishte kryer atë ditë që nuk ishte e vërtetë. **Dr. Sh.** e dinte se deklarata e tij ishte e pasaktë dhe donte që ajo të ishte ashtu që të mos përfshihej në rast dhe për ta mbrojtur veten nga kërcënimet e mundshme.

II. Gjetjet faktike bazohen në vlerësimin e të gjitha provave të pranueshme.

### 1. Faktet e Përgjithshme

Gjykata juridikisht vë në dukje ngjarjet historike lidhur me luftën e Kosovës, tërheqjen e trupave ushtarake të Jugosllavisë dhe Serbisë dhe strukturën e përgjithshme të UÇK-së siç është përshkruar; datat historike janë dhënë në burimet e përbashkëta. Përshkrimi i përgjithshëm i lokacionit të , dhe bazohet në burimet e përbashkëta dhe në deklaratat e dëshmitarëve. Sa i përket distancës ndërmjet dhe – distanca në vij ajrore dhe në rrugën e sotme të asfaltuar- distance e saktë është matur sipas hartës së KFOR-it dhe hartave të marra nga faqja Google. Distanca është rreth km ndërmjet dy vendeve në rrugën e tanishme të asfaltuar sipas hartës së KFOR-it pa dallime të konsiderueshme në lartësi. Saktësia e këtyre provave nuk është vënë në pyetje gjatë zhvillimit të fazës së provave.

Ishte e pakontestueshme dhe e konfirmuar nga shumë dëshmitarë se më , forcat Jugosllave dhe Serbe ishin tërhequr nga , dhe se si pasojë, kishin hyrë trupat e KFOR-it dhe UÇK-së. Kishte disa njerëz të armatosur dhe në uniformë dhe gjithashtu kishte të shtëna në shenjë gëzimi në qendër të qytetit. Shumica e dëshmitarëve kanë thënë se festimet kishin filluar në orët e vonshme të mëngjesit apo rreth mesditës; Dëshmitari Dr. B.G. saktësisht ka thënë se ishte ora para dite. Dëshmitari A.G. (I lindur më ) ka deklaruar para Prokurorit më se ai kishte kuptuar se ishte çliruar në mëngjesin e asaj dite rreth orës apo . Ai ka menduar se kjo kishte ndodhur edhe më herët por akoma frikohej të dilte jashtë. Dëshmitari S.I. i ka përshkruar këto ngjarje si 'eufori' dhe ka deklaruar se fshatrat fqinje ishin çliruar një nga një, duke filluar me fshatin , pastaj . Disa dëshmitarë kanë deklaruar se refugjatët kishin filluar të ktheheshin në shtëpitë e tyre.

Të gjithë dëshmitarët e dëgjuar lidhur me këtë pyetje kanë deklaruar në mënyrë të besueshme se të Pandehurit S. , Rr. dhe H.G. ishin pjesëtarë të UÇK-së në brigadën Nr. deri në fund të luftës si ushtarë të zakonshëm. Një foto i paraqet ata në uniforma kamuflazhe. Ata vetë kanë thënë ashtu kur janë intervistuar në fazën e procedurës paraprake.

Shumë dëshmitarë, përfshirë dëshmitarët N.B. dhe K.Xh.B., kanë konfirmuar se G. dhe V.B. si dhe e gjithë familja B. pretendohet se ishin bashkëpunëtor të Serbëve. Pretendohet se ata kishin kontakte të ngushta me policinë e Serbisë dhe u kanë ofruar për para favore Shqiptarëve të Kosovës që kishin problem me policinë. Nuk është vërtetuar se thashethemet ishin të vërteta. Gjykata është e bindur se kjo ishte arsyeja dhe motivi pse të Pandehurit G. i kishin vrarë ata ( shih në vijim).

Sa i përket kohës kur ishin vrarë G. dhe V., Gjykata është e bindur se vrasja ka ndodhur në orët e vona të pasdites, pas orës por para se të errësohej sipas deklaratave të dëshmitarëve J.B., F.O., Dr. B.M., N.B., I. dhe M.V. Dielli në më ka perënduar pakë kohë pas orës (shih fletët lidhur me perëndimin e diellit). Nuk është mundur të vërtetohet as që ishte e domosdoshme se saktësisht në cilën kohë është shtënë në G. dhe V.B. dhe kur saktësisht kanë vdekur ata. Certifikatat e tyre të vdekjes janë lëshuar shumë më vonë dhe nuk kanë vërtetuar kohën e saktë të vdekjes. Megjithatë, afati kohor ndërmjet orës dhe ishte mjaftë i saktë për ta identifikuar krimin si të tillë. Ishte e pakontestueshme se G. dhe V.B. kanë vdekur më në orët e vona të pasdites.

## 2. Vrasja e V.B. (Pika 1 e aktakuzës)

Trupi Gjykues nuk e ka gjetur të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm pas fazës së provave të shqyrtimit gjyqësor se të Pandehurit S., Rr. dhe H.G. kanë shtënë në dhe e kanë vrarë V.B. më pas orës në qendër të qytetit te udhëkryqi afër qendrës mjekësore dhe ndërtesës së komunës, siç pretendohet në aktakuzë.

Dëshmitari J.B. i ka deklaruar Gjykatës se më kishte qenë në qendër të qytetit te udhëkryqi. Ai kishte dëgjuar të shtënat që i identifikon se ishin bërë nga pushka Kalashnikov dhe për këtë shkak ai ishte kthyer prapa; e shtëna ishte tepër e shkurtër për ta identifikuar se prej kah kishte ardhur. Dëshmitari ka përshtuar se kishte parë S., Rr. dhe H. G. në uniforma të UÇK-së disa metra larg vendit ku viktimat V. dhe G.B. ishin qëlluar dhe rrëzuar në tokë. Ai nuk kishte parë një apo më shumë nga të Pandehurit G. të ketë hapur zjarr. Ai vetëm ka konkluduar se ata kishin bërë këtë sepse i kishte parë që po qëndronin shumë afër viktimave dhe për shkak të asaj që kishte ndodhur më vonë në qendrën mjekësore (shih në vijim).

Dëshmitari B. Z. i – i afërm i G. dhe V.B. – ka dëshmuar në Gjykatë se më, e kishte parë trupin e V.B. të shtrirë te udhëkryqi në qendër të qytetit, por nuk i kishte parë të Pandehurit S., Rr. dhe H. G. atë ditë. Kjo kundërshton deklaratën e tij dhënë Prokurorit më. Atëherë, ai kishte thënë se e kishte parë S.G. – të armatosur dhe në uniform të UÇK-së- bashkë me dy dëshmitarët L.G. dhe S. në ditën kritike. Ata kishin qenë rreth m larg nga vendi ku e kishte parë trupin e shtrirë të V. Kur është ballafaquar me këtë mospërputhje, dëshmitari ka pohuar se deklarata e tij si dëshmitar para Prokurorit nuk ishte regjistruar në mënyrë të saktë. Ai nuk kishte ditur se çka po nënshkruante. Përmbajtja e procesverbalit ishte e tëra fabrikim i Prokurorit. Dëshmitari ka deklaruar se një përkthyes nga gj. Shqipe ka qenë i pranishëm në atë kohë, por ai vetëm i kishte thënë ta nënshkruaj një dokument për të konfirmuar se ai ishte prezent.

Dëshmitari N.B. – nip i të ndjerëve G. dhe V.B. – i ka deklaruar Gjykatës se ishte në më . Në orët e vona të pasdites para se të errësohej kishte qenë duke punuar për daj të G. dhe V. . Në qendër të qytetit ka arritur të udhëkryqi ku ka parë dajën e tij V. të vdekur të shtrirë në tokë. Ai nuk e kishte parë G. . Ai ka deklaruar se vetëm pak kohë më vonë e kishte parë të Pandehurin **S. G.** i cili ishte shofer i një veture ngjyrë të kuqe që ishte parkuar afër qendrës mjekësore. **S.G.** ka hyrë edhe në qendrën mjekësore. Megjithatë, ai nuk kishte parë se kush kishte shtënë në G. dhe V. .

Dëshmitarët tjerë si Dëshmitari Z.A. , Dr. B.M. , Q.A. , S.I. , L.G. , G.G. dhe S.G. kanë deklaruar se në përgjithësi kanë qenë prezent në më pasdite. Megjithatë, asnjë nga ta nuk mund t'i ofronin Gjykatës asnjë informatë lidhur me pyetjen se kush kishte shkreput plumbat që kishin qëlluar G. dhe V.B. në rrugë.

Gjykata nuk ka konkluduar nga deklaratat e lartcekura dhe nuk është bindur përtej dyshimit të arsyeshëm pas fazës së provave së shqyrtimit gjyqësor se të Pandehurit **G.** - qoftë një apo më shumë nga ta- kanë shtënë dhe kanë vranë V.B. . Ishte e pa kontestueshme dhe e konfirmuar nga të gjithë dëshmitarët se kishte pasur të shtëna me armë në shenjë gëzimi që po vazhdonin kur janë qëlluar G. dhe V. ; nuk mund të përjashtohet deri në shkallën e nevojshme se viktimat ishin qëlluar nga plumbat e rastit. Ngjarjet e mëvonshme në qendrën mjekësore tregojnë, por nuk vërtetojnë mjaftueshëm përtej dyshimit të arsyeshëm se ishte njëri apo më shumë nga të Pandehurit **G.** që kishte shtënë në viktimat. E njëjta gjë vlen për faktin se **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** kanë qenë të pranishëm në atë vend. Gjykata vë në dukje faktin se vëllezërit B. ndjeheshin komod në festimin e çlirimit të që sugjeron se nuk ishin bërë kërcënime mjaft të precizuara ndaj tyre dhe se ata nuk frikoheshin për jetën e tyre. Madje edhe po të kishte ndonjë kërcënim të përgjithshëm- të theksuar dhe artikulluar- kundër bashkëpunëtorëve shprehur nga UÇK-ja , siç i kishte thënë Dëshmitari J. Gjykatës , si duket ajo nuk ka qenë mjaftë konkrete dhe e drejtuar në ndonjë mënyrë kah vëllezërit B. që ata do të kishin qëndruar larg nga vendet publike. Nuk është mundur të vërtetohet se të Pandehurit **G.** e kanë ditur apo vetëm kanë shpresuar t'i gjenin G. dhe V.B. në turmë në qendër të qytetit që t'i vrasin. Më së shumti ka gjasa që **G.** kishin ardhur nga në për të njëjtat arsye si çdonjëri tjetër për ta festuar tërheqjen e forcave Jugosllave dhe Serbe.

Por madje edhe sikur hipoteza e Prokurorisë të ishte e drejtë dhe të ishte njëri nga të Pandehurit **G.** që kishte shtënë në V. dhe G. , nuk do të kishte bazë të mjaftueshme për ta dënuar secilin nga ta për pikën për të cilën akuzohen. Pasi që nuk ishte e qartë se kush kishte shtënë dhe se, qitësi ka mundur të vendoste ta bënte këtë pa dijeninë e të tjerëve relevant. Gjykata do të duhej pastaj të aplikonte parimin *in dubio pro reo* për secilin nga të tre të Pandehurit **G.** për arsye ligjore, përveç nëse ka pasur plan të përbashkët për të vranë. Nuk ka prova të mjaftueshme për ta vërtetuar një plan të tillë të përbashkët të të Pandehurve **G.** për t'i vranë G. dhe V.B. ( tashmë ) në rrugë, sepse, siç u cek më lartë, ata nuk kanë mundur të ishin të sigurt se vëllezërit B. do të ishin aty. Prandaj, për këtë të shtënë e parë, Gjykata nuk ka mundur të gjejë elementet e mjaftueshme për ta lidhur ndonjë plan të mundshëm të një apo më shumë të Pandehurve **G.** për vrasjen e V.B. .

Duke ditur këtë rezultat, Gjykata nuk ka pasur nevojë që ta vlerësojë matej besueshmërinë e deklaratave të dëshmitarëve në këtë fazë. Ajo vetëm vë në dukje se dëshmitari B.Z. duket qartë se nuk e ka treguar të vërtetën kur ka dhënë deklaratë në Gjykatë. A kishte nënshkruar një deklaratë prej gjithsej 4 faqesh me nënshkrimin e tij në çdo faqe që qartazi minon pretendimin e tij të pabesueshëm- se Prokurori ka futur diçka në procesverbal që ai, Dëshmitari, nuk e kishte thënë dhe atij vetëm i është thënë ta nënshkruaj konfirmimin se ishte i pranishëm.

Faktet e dhëna në pikën1 të Aktakuzës sa l përket V.B. prandaj nuk janë vërtetuar.

### 3. Plagosja e palëve të Dëmtuara l. dhe M.V. (Pika 2 e Aktakuzës)

Sipas argumentimit të mësipërm nën pikën 1. Gjykata nuk e ka gjetur të vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se Palët e dëmtuara l. dhe M.V. ishin qëlluar nga plumbat e shkrepur nga të Pandehurit G. në G. dhe V.B., siç pretendohet në Aktakuzë.

Pala e Dëmtuar l.V. ka deklaruar në gjykatë se më kishte dalë me vëllain e tij në qendër të qytetit në , Në qendër të qytetit po vazhdonin të shtënat me armë zjarrin në shenjë gëzimi. Ai është qëlluar në pjesën e poshtme të djathtë të abdomenit dhe ishte rrëzuar në tokë; ai megjithatë është ngritur prapë në këmbë dhe ka shkuar në drejtim të ndërtesës së komunës ku ishte rrëzuar prapë. Atje kishte marrë ndihmën e parë nga ushtarët e KFOR-it dhe nga Dëshmitari Dr M. . Ai e ka humbur vetëdijen. Dëshmitari nuk ka mundur të thotë se a ka shtënë dikush me qëllim në të apo është qëlluar nga plumbat e rastit. Ai nuk ka parë të Pandehurit G. atë ditë.

Pala e dëmtuar dhe Dëshmitari M.V. ka dhënë dëshminë se më kishte arritur në Skenderaj pas dite në një kohë të pacaktuar por para se të errësohej. Ai ishte qëlluar nga një plumb në pjesën e poshtme të këmbës së djathtë dhe kishte kuptuar se vëllai l tij, Dëshmitari l. V. , ishte plagosur rëndë në pjesën e abdomenit. Dëshmitari M. pastaj kishte shkuar në qendrën mjekësore ku nuk kishte mundur të gjente ndonjë mjekë apo infermier për t'i ndihmuar. Ishte kthyer prapë në rrugë, kishte takuar Dëshmitarin Dr. M. dhe e kishte sjellë te vëllai i tij i plagosur kur Isa tashmë kishte marrë ndihmën e parë nga KFOR-i . Ai nuk ka mundur të thotë se kush kishte shkrepur plumbat që e kishin qëlluar atë dhe pse. Ai nuk kishte parë të Pandehurit atë ditë.

Të dy vëllezërit nuk kanë qenë të qartë kur kemi të bëjmë me lokacionin e saktë ku ishte shtënë në ta. Deri sa l. ka thënë se ishte një distancë rreth 30-40 m nga qendra mjekësore, M.V. ka pohuar se distanca ishte - m.

Siç u cek më lartë, dëshmitarët Z.A. , Dr B.M. , Q.A. , S.I. , L.G. , B.Z. , N.B. , G.G. dhe S.G. nuk kanë mundur të ofronin informata tjera lidhur me të shtënat në rrugë; nuk është vërtetuar se ata ishin prezent mu në kohën kur kishte ndodhur ajo.

Dëshmitarja në rolin e ekspertit **Dr. C.B.** e cila i ka ekzaminuar të dy Palët e Dëmtuara gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se ishte e pamundur të thuhej nga pikëpamja mjekësore se nga cili drejtim dhe në cilin këndë janë shkrepur plumbat që kanë shkaktuar plagosjen e l. dhe M. , sidomos nëse ato janë shkaktuar nga të shtënat e qëllimta apo nga plumbat e rastit, sepse ata kanë tejkaluar indin e butë dhe ka gjithashtu mundësi të ju ketë ndërruar drejtimi nga ndonjë objekt i fortë. Prandaj, ajo nuk ka mundur t'i ofrojë Gjykatës informata lidhur me natyrën e

plagosjeve dhe ekspertiza e saj nuk ka qenë e dobishme as për të vërtetuar identitetin e kryerësit(ëve) të mundshëm.

Në vlerësimin e provave të lartcekura, i vetmi fakt që Gjykata ka mundur ta vërtetojë është se I. dhe M.V. ishin qëlluar kur po qëndronin në afërsi të G. dhe V.B. dhe se ata ishin plagosur në të njëjtën kohë. Megjithëse S. , Rr. dhe H.G. ishin drejtpërdrejt në vend të ngjarjes, sipas dëshmitarit J.B. , dhe një apo ma shumë syresh kanë mundur teorikisht të ishte ai (ata) që kanë shkrepur të shtënat që kanë plagosur I. dhe M.V. , janë mbledhur prova të pamjaftueshme për ta lidhur njërin nga veprimet e tyre të mundshme por jo vërtetuar me lëndimet që kishin pësuar vëllezërit V. . As nuk mund të përjashtohet plotësisht se I. dhe M.V. janë qëlluar nga plumbat e rastit apo plumbat rikoshet që janë shkrepur në G. dhe V.B. apo janë qëlluar nga ndonjë plumb tjetër i rastit, as nuk është mundur të vërtetohet kush- nëse ndonjëri- nga të Pandehurit G. ka shtënë. Prandaj, parimi *in dubio pro reo* do të aplikohet në favor të secilit të Pandehur edhe në këtë rast (shih argumentimin më lartë).

Faktet e paraqitura në pikën 2 të Aktakuzës prandaj nuk janë vërtetuar.

#### 4. Vrasja e G.B. (Pika 1 e Aktakuzës)

Gjykata ka konstatuar se është vërtetuar përtej dyshimit të arsyeshëm se të pandehurit S. , Rr. dhe H.G. e kanë vrarë G.B. në veprim të përbashkët në qendrën mjekësore në . Ajo është bindur se Dëshmitari J.B. ka përshkruar ngjarjet të cilat i kishte parë saktësisht dhe se ai nuk kishte qenë më në pasditen e datës . Të pandehurit G. kanë shtënë në G.B. në qendrën mjekësore në . Të pandehurit G. nuk kanë qenë në fshatin e tyre kur ishte shtënë në G. (dhe V. ).

Gjykata ka dëgjuar 28 dëshmitarë dhe ka analizuar deklaratat e tyre dhe disa deklarata tjera që ishin dhënë në polici dhe/ose në Prokurori në fazën e procedurës paraprake.

Në vlerësimin e deklaratave të dëshmitarëve Gjykata ka qenë në dijeni se në përgjithësi është indikacion – jo provë- për deklaratën e besueshme nëse jepet me siguri, ndërsa deklarata e pabesueshme përmban pasiguri. Kjo bazohet në njohurinë e përgjithshme psikologjike se është më lehtë të tregohet e vërteta se sat ë tregohet dhe rekapitullohet gënjeshtër, sepse personi i ndershëm duhet vetëm të aktivizojë fotografitë tashmë të memorizuara të ngjarjes në vend se të shpikë gjërat që është dukshëm më vështirë. Është megjithatë standard psikologjik dhe pjesë e njohurisë profesionale ë Trupit Gjykues se rikujtimi njerëzor zbehet pas kalimit të kohës dhe se truri i njeriut- qëllimisht apo pa vetëdije- gjithashtu shpesh tregon tendencë të modifikimit dhe mbushjes së zbrazëtirave për t'i bërë gjërat më të besueshmes. Është gjithashtu normale që truri i njeriut së pari harron detajet të cilat konsideron se nuk janë të rëndësishme, dhe dëshmitarët e korrigjojnë veten në deklaratat e mëtejme. Në përgjithësi deklarata është më e saktë nëse jepet menjëherë pas ngjarjeve kritike se sa deklarata që jepet pas disa viteve. Në këtë rast, megjithatë, kjo rregull nuk vlen. Të gjithë dëshmitarët kanë dhënë deklaratat në prokurori/polici dhe në Gjykatë apo vjet pas datës . Prandaj, është logjike që deklarata e dhënë prokurorit në vitin apo mund të jetë- por jo domosdoshmërisht më e saktë se sa deklarata e dhënë disa muaj më vonë në gjykatë gjatë shqyrtimit gjyqësor. Duke pasur këtë parasysh, Gjykata ka konstatuar esenciale



t'i kushtohet kujdes mënyrës që dëshmitarët kanë performuar në Gjykatë gjatë dhënies së dëshmimeve dhe të merret përshtypje e sigurt personale për ta.

#### 4.1. Ngjarjet në

Në dëshminë e tij, J.B. ka përshkruan ditën e . Ai ka qenë pjesëtar UCK-së në atë kohë, por në një brigadë tjetër nga ajo e S. , Rr. dhe H.G. .Ai posedonte një pushtë snajper dhe tri granata dore. Gjatë luftës ai rrinte në shtëpinë e madhe të vëllait të tij E. sepse shtëpia e tij ishte djegur gjatë luftës. Pjesët e familjes së tij, përfshirë bashkëshorten dhe fëmijët e tij të vegjël në atë kohë, dëshmitarët B. dhe B.B. , ishin në sepse ishte më e sigurt që ata të rrinin atje. Shumë anëtarë të familjes dhe refugjatë tjerë gjithashtu kishin gjetur strehim në shtëpinë e E. në atë kohë. Më në një moment rreth mesditës ai kishte dëgjuar helikopterët e NATO-s që po fluturonin mbi . Njerëzit në fshat i përshëndetnin dhe shtinin me armë në shenjë gëzimi. Ndryshe nga ajo që kanë thënë dëshmitarët tjerë, ai nuk kishte hedhur granatë dore më nga gëzimi; megjithatë, kishte konfirmuar se e kishte e hedhur një granatë dore disa javë para se të përfundonte lufta, por vetëm që t'i frikësonte Serbët që të largoheshin. Kur kuptuan se Serbët po tërhiqeshin, ai dhe vëllai i tij i ndjerë Xh. kishin vendosur që të shkonin në . Ata kishin kaluar një pjesë të rrugës nëpër një rrugë të shkurtë këmbësorësh. Gjatë rrugës kishin kaluar pranë një fshati të quajtur

. Aty afër, një shofer traktori me njerëz në rimorkio i kishte lutur që të hipnin me ta në traktor për në . Atij nuk i kujtohet emri i shoferit të traktorit apo personave tjerë në traktor. Ata kishin refuzuar ofertën sepse Xh. preferonte të ecnin rrugës gjë të cilën nuk kishin mundur ta bënin gjatë luftës. Vendi tjetër ku kishin arritur ishte fshati . Në një vend, depo traktorësh, ata kishin shikuar nëse mund ta gjenin një traktor që më parë i ishte vjedhur Xh.

. Kur nuk ia arritën ta gjenin, ata vazhduan rrugën për ku arritën rreth orës pas dite; dëshmitari megjithatë nuk ishte i sigurt për kohën e saktë kur kishin arritur atje. Ai dhe Xh. po shëtisnin nëpër qytetin e që po festonte. Dëshmitarit i kujtohet se kishte parë dëshmitarin G.G. te dyqanet e tij por se nuk ishte i sigurt nëse edhe G. e kishte parë atë. J. gjithashtu vendosi të shikonte një banesë në qendër të qytetit të që ishte braktisur nga një Serb dhe të cilën shpresonte ta uzurpojë. Brenda në banesë e kishte takuar dëshmitarin Z.A. i cili ishte i shtrirë në shtrat në dhomën e gjumit të asaj banese veshur në rroba sportive (trenerka). J. pas një bisede të shkurtë me dëshmitarin A. kuptoj se kishte ardhur tepër vonë për ta uzurpuar banesën dhe u kthye në rrugë.

Gjykata është e bindur se përshkrimi i J. që u bënë këtyre ngjarjeve ishte i saktë, edhe pse shumë dëshmitarë kishin pohuar se J. nuk kishte qenë fare në , por tërë ditën kishte qenë në fshatin e tij, . Dëshmitarët kishin marrë si pikë referuese një moment kur J.

pretendohet se kishte hedhur një granatë dore për të festuar dhe në shenjë gëzimi; dëshmitarët kanë pohuar se kjo kishte ndodhur dikur vonë pasdite që e bënë praktikisht të pamundur që J. të ishte në të njëjtën kohë në vendin e ngjarjes në , edhe pse koha e saktë e vrasjeve nuk ka mundur të vërtetohet. Ishte diku pas orës pas dite, dhe gjithsesi para perëndimit të diellit.

Dëshmitari E.B. – vëllai i J. dhe i të ndjerit Xh.B. –ka dëshmuar në gjykatë se familja ishte mbledhur para shtëpisë në një fushë. Disa njerëz thoshin se Kosova do të çlirohej, disa ishin skeptik lidhur me këtë fakt. Tanimë ishte vonë pas dite kur ata kishin parë dy

vetura që po kalonin pranë fshatit dhe një helikopter. Ai ishte frikësuar sepse kishte menduar se ishin Serbët dhe ishin përgatitur që të iknin në male për t'i mbijetuar sulmit të mundshëm. Pastaj, kishte mësuar se faktikisht kishte qenë KFOR-i. Ai nuk e kishte parë vëllain e tij J.B. që kishte hedhur granatë dore, por kishte dëgjuar një shpërthim dhe dikush i kishte thënë se J. e kishte bërë atë. Ai ishte plotësisht i sigurt se vëllezërit e tij J. dhe Xh. kishin qenë në shtëpinë e tij pjesën e mbetur të ditës dhe natën sepse fillimisht ata do ta kishin njoftuar atë si vëllain më të madh nëse kishin për qëllim të largoheshin. Ata nuk kishin vepruar ashtu. Së dyti, të gjithë kishin qëndruar në pjesën tjetër të ditës, sepse asnjë nuk ishte plotësisht i sigurt se kishte mjaftë siguri që të largoheshin nga . Vëllai i tij J. duhej ta konsultonte një psikiatër nëse vazhdon të pohojë se ishte dëshmitar okular i vrasjeve që kishin ndodhur në Skenderaj më . J. asnjëherë nuk i kishte thënë atij si vëllai më i madh për këto ngjarje dhe për atë që kishte parë.

Dëshmitari A.B. – i biri i E.B. – në ditën kritike ka qenë në në shtëpinë e babait të tij E. . Ai nuk e kishte parë shpërthimin pasi që kishte qenë brenda në oborrin e shtëpisë. Ai ka deklaruar se vetëm e kishte dëgjuar atë dhe axha i tij J. vetë i kishte thënë se e kishte hedhur një granatë dorë kur ishte bashkë me dëshmitarin H.M. . Kjo kishte ndodhur në orët e vona të pasdites, pasi kishte arritur KFOR-i në fshat. J. atëherë me siguri ka qenë në shtëpinë e E. apo aty afër gjatë tërë ditës.

Dëshmitari H.K. – dhëndër i E.B. – ka dëshmuar në gjykatë se me , pas dite, kishte qenë te porta e shtëpisë së E. kur kishte dëgjuar të shtënat që vinin nga afër . J.B. dhe H.M. kishin shkuar në drejtim të fushës, dhe J. kishte hedhur një granatë dore pa ndonjë lajmërim paraprak. Ishte një granatë dore standarde – e gjelbër dhe e rrumbullakët me siguresë – dhe me çarje në sipërfaqe. J. e kishte hedhur granatën e dorës jashtë shtëpisë së E. teposhtë në distancë - m nga pika ku po qëndronin ai dhe dëshmitari. Aty kishte persona tjerë në distancë prej m, duke përfshirë A. B. . E.B. kishte ardhur dhe kishte filluar të bërtas dhe ta shajë vëllain e tij. J. i ka shpjeguar se granatën e kishte hedhur sepse ishte çliruar . Ai – dëshmitari, mund të garantonte se J. tërë ditën kishte qenë në K. dhe faktikisht askush nuk ishte larguar nga fshati deri të nesërmen më .

Dëshmitari H.M. nuk ka konfirmuar këtë version të dëshmitarëve H.K. dhe A.B. . Atij nuk i kujtohej se J.B. kishte hedhur granatë dore dhe ka deklaruar se po të kishte shpërthim të tillë, granata ka mundur të hidhej nga cilido. Nëse J. kishte vepruar ashtu, do duhej të ishte larg nga shtëpia. Ai nuk ka thënë se kishte shkuar në fusha bashkë me J. B. kur ky i fundit kishte hedhur granatën e dorës, si shumë dëshmitarë donin që Gjykata ta besonte këtë.

Dëshmitari H.B. – nip i J. dhe i biri i të ndjerit Xh.B. – ka deklaruar se më shumë anëtarë të familjes kanë qenë në , por nëna dhe motra e tij dhe disa fëmijë kanë qenë në për shkaqe sigurie. Kur kishin dëgjuar njerëzit që po shtinin me armë në fshat, kishin menduar se Serbët do të sulmonin; ai dhe të tjerët ishin frikësuar dhe ishin grumbulluar afër pyllit, të gatshëm për të ikur. Pastaj kishin kuptuar se njerëzit po shtinin me armë për të festuar çlirimin. Ai pastaj kishte dëgjuar një shpërthim - m larg dhe më vonë atij i është thënë se J. kishte hedhur një granatë dore prej gëzimit. E tërë kjo kishte ndodhur më vonë

pasdite. Ai, H. , kishte ndenjtur me të dy xhaxhallarët e tij, E. dhe J. , tërë ditën në shtëpi. Atij nuk i kujtohej saktësisht se çka kishte bërë J. gjatë tërë kohës. I pyetur për atë se çka i kishte ndodhur babait të tij, Xh.B. , dhe vëllait të tij, B.B. , ai ka deklaruar se ata ishin vrarë në një pritë në vitin . Ata dhe gjithashtu anëtarë të tjerë të familjes, F. dhe J.B. kishin qenë – legalisht – duke prerë dru në qershor të vitit . Në ta ishte shtënë nga distanca. F.B. ishte plagosur dhe gjithashtu edhe Dëshmitari J.B. . Këto ngjarje nuk janë jetuar deri më tani.

Deklarata e dëshmitarit H.B. kundërshtohet nga deklaratat e dhëna nga dëshmitarët B. dhe B. B. – të dy djem të dëshmitarit J.B. . Gjersa, H.B. i ka thënë Gjykatës së ai kishte qenë në gjatë tërë kohës në përfundim të luftës, të dy dëshmitarët kanë deklaruar në mënyrë të besueshme se H. kishte qenë me ta dhe pjesët tjera të familjes në sepse kishte më pak rrezik për ta. Trupi Gjykues i beson B. dhe B.B. dhe është i bindur se H.B. nuk ka treguar të vërtetën dhe se ai kishte qenë me fëmijët tjerë në . Më H. ishte vjeç. Qe nga fillimi i deklaratës së parë të tyre dhënë Prokurorit më B. dhe B.B. ishin shumë të qartë dhe të vendosur se kënd e kishin parë në dhe kënd nuk e kishin parë, edhe pse të dy kishin qenë të rinj në atë kohë ( vjeç dhe vjeç). Megjithatë, moshja si e tillë nuk e parandalon të kujtuarit e saktë. Meqë të dy dëshmitarët dhe J.B. kanë thënë, një pjesë e familjes ka qenë në dhe është sjellë në shtëpi në me traktor vetëm kur situata kishte qenë e sigurt. J.B. i kishte marrë ata më nga . Edhe nëse dëshmitarët (e rinj) nuk e dinin saktësisht se çka kishte bërë H. po atë ditë, ata do ta kishin vënë re nëse vjeçari i asaj kohe, H. të kishte shkuar vetëm dhe një ditë më parë se sa pjesa tjetër e familjes në , sepse kjo do të kishte qenë situatë e jashtëzakonshme. Gjykata ka përjashtuar mundësinë që B. dhe B. nuk kishin treguar të vërtetën në Gjykatë sepse ata dëshironin të konfirmonin versionin e babait të tyre, J. , të ngjarjeve më . Të dy dëshmitarët tashmë kishin dhënë saktësisht të njëjtën deklaratë në Prokurori në të vitit , dhe në këtë moment ata nuk kanë mundur ta dinë se cili dëshmitar do të ishte i rëndësishëm për atë rast dhe çka saktësisht kishte thënë H. B. në Prokurori më . Nuk ka pasur arsye që ata të gënjejnë sepse H.B. ka qenë vetëm njëri nga dëshmitarët e shumtë nga i dhe jo dëshmitar kyç i rastit. Kjo situatë dallon nga situata e dëshmitarëve të it, ku ata (të gjithë) kanë deklaruar kundër J.B. t si dëshmitar vendimtar i këtij rasti. Gjykata ka konstatuar se deklaratat e B. dhe B. ishin të besueshme.

Dëshmitari J.R. – dhëndër i të ndjerit Xh.B. – ka dhënë deklaratat të ndryshme në Prokurori më dhe në Gjykatë më . Në deklaratën e parë ka thënë se një granatë dore ishte hedhur dhe ai e vendos këtë ndërmjet orës  dhe  para dite, menjëherë pasi që ai kishte parë automjetet e KFOR-it (shih deklaratën dhënë Prokurorit, pyetja Nr. ). Pastaj ishte nisur me djalin e tij për të shkuar në fshatin e tij . Gjykatës megjithatë i ka thënë se ngjarja e granatës së dorës kishte ndodhur në orët e vona të pasdites dhe se ai dhe djali i tij më pastaj ishin larguar nga . Ai nuk i ka thënë të vërtetën Prokurorit; ai e ka kuptuar gabimin e tij qysh në ditën e intervistës më pasi kishte biseduar me djalin e tij H. i cili ia kishte përkujtuar kohën e saktë. Ai, J. , nuk kishte ndier nevojën që të që të kthehej te Prokurori e ta korrigjonte gabimin që kishte bërë.

Dëshmitari djali i J.R. dhe nipi I të ndjerit Xh.B. , dëshmitari H.R. , i ka thënë policisë në deklaratën e tij të fazës së procedurës paraprake të datës se ai kishte ndenjur në shtëpinë e Enverit vetëm deri në orët e hershme të pasdites dhe pastaj ishte nisur për Mitrovicë me babën e tij; ata ishin ndarë gjatë rrugës kur J. kishte shkuar në fshatin e tyre . Gjykatës dëshmitari H.R. i ka deklaruar se kishte qenë pothuajse në mbrëmje, kur po errësohej, kur ata të dy ishin larguar nga . KFOR-I gjithashtu kishte arritur në orët e vonat të pasdites. Ai e kishte parë J. që kishte hedhur diçka dhe pastaj kishte ndodhur një shpërthim. Ai në këtë moment kishte qenë rreth m larg nga J. dhe I është dashur të shtrihet në tokë. Kur dëshmitari është ballafaquar me intervistën e tij të procedurës paraprake dhe me mospërputhjet sa i përket kohës së shpërthimit të granatës së dorës, ai ka pohuar se procesverbali i deklaratës dhënë Prokurorit ishte jo i saktë. Ai megjithatë ka konfirmuar, siç paraqitet në procesverbal, se përmbajtja I ishte ri-përkthyer në gjuhën Shqipe dhe se ai me pastaj e kishte nënshkruar atë.

Dëshmitari F.H. ka dëshmuar më se më kur KFOR-i kishte hyrë në , J.B. kishte hedhur një granatë dore. Ai ishte rreth - m larg. Granata e dorës ishte e gjelbër, në formë ovale dhe kishte çarje. Dëshmitari ishte shumë i sigurt se e kishte parë atë. Ai nuk e kishte parë shpërthimin si të tillë sepse J. e kishte hedhur granatën e dorës përtej një kodre të vogël. Atij i është dashur të shtrihet në tok. Më vonë, pas drekës ai kishte shkuar në për ta vizituar të fejuarën e tij të cilën nuk e kishte parë për një kohë të gjatë gjatë luftës. Ai ka thënë se kishte drekuar rreth orës - pas dite, pastaj kishte parë KFOR-in dhe pastaj ishte larguar nga i rreth orës - pas dite. Ai kishte ecur në këmbë që kishte zgjatur - orë.

Dëshmitari M.H. i ka deklaruar Prokurorit më se KFOR-i kishte arritur rreth mesditës në .

Dëshmitarja A.B.H. i ka deklaruar Prokurorit më se e kishte parë J.B. vetëm atëherë kur kishte hyrë KFOR-i por më pastaj nuk e kishte parë më. Ajo nuk ka mundur të dëshmojë për shkak të problemeve mjekësore.

Dëshmitarja S.B.R. – kunatë e J.B. t – i ka deklaruar Prokurorit më se nuk e kishte parë J.B. n më . Asaj vetëm i kishin thënë se ai e kishte bërë atë. Pak para se të errësohej kishte parë tanket e KFOR-it që po kalonin atypari, kjo ka qenë pasi kishte shpërthyer granata e dorës. Ajo vetë nuk e kishte dëgjuar shpërthimin sepse kishte pengesa me të dëgjuarit.

Dëshmitari Z.A. ka deklaruar në Gjykatë se më , pas dite rreth një kishte qenë në banesën që përpara i takonte një Serbi i cili kishte ikur. I pyetur nëse kishte parë Dëshmitarin J.B. , ka deklaruar se ishte “100 % i sigurt” se J. atë ditë nuk kishte qenë në këtë banesë, por atë e kishte takuar aty - ditë më vonë. Vetëm atëherë kishte ndodhur takimi i papritur të cilin e kishte përshkruar J. .

Dëshmitarët G.G. dhe S.G. kanë deklaruar në deklaratat e tyre të datës respektivisht se kishin qenë nëpër por nuk e kishin parë J. më . Asnjë dëshmitar tjetër që është dëgjuar në Gjykatë apo deklaratë e të cilit është konsideruar e lexuar nuk e kishte parë J.B. t atë ditë në .

Gjykata është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se dëshmitarët të cilët kanë thënë J. ishte ende në vonë) pasdite dhe kishte hedhur një granatë dore në këtë kohë, nuk e kanë thënë të vërtetën. Në ekzaminimin e tyre, gali të gjithë dëshmitarët kanë dhënë përshtypje të fortë se kishin ardhur në Gjykatë vetëm për të konfirmuar këtë fakt të veçantë për ta diskredituar J.B. , në vend se të përpiqeshin që ta rikujtonin me kujdes se çka saktësisht kishte ndodhur më . Duke aplikuar standardet e lartcekura të vlerësimit të deklaratave të dëshmitarëve, Gjykata nuk ka vënë theksin në mospërputhjet e vogla në deklaratat e dëshmitarëve të it dhënë Prokurorit dhe Gjykatës, dhe në deklaratat e dëshmitarëve krahasuar me njëra tjetrën. Disa mospërputhje të vogla mund të shpjegohen lehtë me humbjen e kujtesës pas vjetësh nëse dëshmitarit nuk i kujtohet saktësisht kush ishte kur ishte brenda në shtëpi apo në oborr, apo se a ishte ora - kur kishte arritur KFOR-I apo ndoshta ishte madje apo , rreth kohës së drekës. Gjykata megjithatë është e bindur njeriu do duhej mbajtur mend se a ishte mesi I ditës kur njerëzit kishin mësuar se lufta e Kosovës kishte përfunduar në regjionin e tyre apo ishte vonë pasdite, sidomos kur, siç është vërtetuar më vonë, për shumë njerëz në rajon ishte esenciale që të ktheheshin në shtëpitë e tyre sa më shpejt që ishte e mundur.

Gjykata, siç u cek më lartë, është larguar nga përmbajtja e deklaratave kryesisht duke vlerësuar përshtypjen personale që ka fituar nga dëshmitarët e , mënyrën se si janë përgjigjur, mimikën dhe gjestet, që nuk kanë bindës në pjesët kur ata devijonin nga gjetjet faktike nga Gjykata. Dëshmitari H.M. p.sh. që ishte hutuar- me gjasë për shkak të moshës së shtyrë- ka thënë i sigurt se J.B. tërë ditën kishte qenë në ; ndërsa atin vështirë se mund ti kujtohej çdo gjë tjetër që kishte ndodhur atë ditë. Gjykata e ka marrë këtë si provë se ai kishte vendosur apo I është thënë të konfirmojë praninë e J. .

Sa i përket kësaj, dëshmia e E.B. ishte e dalluar që provonte të shpjegojë pse J. nuk kishte mundur të shkonte në . Ai ka thënë se as anëtarët e familjes nuk ishin të sigurt nëse ishte çliruar ; as J. dhe Xh. nuk do të ishin larguar pa e lajmëruar atë si vëllai më i madh. Asnjëra arsye nuk ishte bindëse. Nga deklaratat e dëshmitarëve F.H. , J.R. dhe H.R. del qartë se njerëzit faktikisht ishin larguar nga i , dhe , kështu Gjykata është bindur, posa kishte qenë e mundur posa kishin mësuar se rrugët ishin të lira, sidomos në rastin e dëshmitarëve të cilëve u nevojiteshin - orë që të ecnin deri në . Pasi që është vërtetuar se personat kanë guxuar të largoheshin nga i, deklarata e E. B. se njerëzit frikoheshin të largoheshin thjesht nuk ka kuptim dhe gjithashtu bie ndesh me atë që kishte thënë para Prokurorit, përkatësisht se njerëzit po bënin shaka atë pasdite për shkak të çlirimit të rajonit( përgjigja në pyetjen Nr. të Prokurorit). Gjykata gjithashtu nuk ka besuar se J. dhe Xh. do të kishin nevojë për "lejen" e E. për t'u larguar.

I njëjti padurim për ta bindur Gjykatën se J. nuk kishte mundësi të ketë qenë në në ditën kritike ishte i dukshëm kur behet fjalë për distancën ndërmjet it dhe . Është e qartë se sa më e madhe të jetë distanca ndërmjet dy destinacioneve aq më shumë kohë do ti duhej J. që të arrijë atje dhe do të ishte më pak e besueshme se ai kishte parë vrasjet që kishin ndodhur pas orës pas dite në qendër të qytetit të . J.B. ka thënë se ai kishte ecur nëpër një rrugë më të shkurtër këmbësorësh dhe iu kishte dashur më shumë se të arrijë në por nuk ka mundur të thotë saktësisht se sa kohë iu kishte nevojitur. Kjo ka kuptim, sepse në kohën kur kanë filluar të ecnin për në ai nuk ka mundur të parashihte se çka do mund të shihte më vonë në Skenderaj dhe prandaj nuk ishte nxitëse që ai të

memorizonte kohën konkrete me minuta. E.B. i ka thënë Gjykatës se gjatësia nëpër rrugë do të ishte rreth km, ndërsa Dëshmitari H.B. ka llogaritur se distanca është km e gjatë. Sipas hartës së KFOR-it, distanca në rrugën e tashme të asfaltuar ndërmjet it dhe është rreth km pa dallim të dukshëm në topografi. Gjykata ka konstatuar se e vetmja arsye pse dëshmitarët do ta llogarisnin distancën ndërmjet it dhe kaq shumë ndryshe se që është në realitet- gjë të cilën E. dhe H.B. e kanë ditur sepse tërë jetën kanë jetuar në - ishte se ata kishin planifikuar të mos e thoshin të vërtetën në Gjykatë.

Gjykata ka gjetur të domethënës faktin se sa më shumë që ka zgjatë shqyrtimi gjyqësor aq më shumë kishin parë dëshmitarët. Dëshmitarët H.K. , F.H. dhe H.R. të cilët janë dëgjuar më dhe i kanë thënë Gjykatës se të gjithë me sytë e tyre kishin parë ndodhjen e ngjarjes së granatës së dorës dhe dy nga ta madje kanë përshkruar edhe granatën e dorës, ndërsa dëshmitarët të cilët janë dëgjuar në fazën e mëhershme të shqyrtimit gjyqësor kanë qenë më të kujdesshëm dhe kanë thënë se gjoja ai e kishte hedhur atë. Gjykata ka besuar se këta dëshmitarë kanë vepruar kështu sepse Gjykata që ua kishte vazhduar masën e paraburgimit kundër të Pandehurve G. në disa raste qartazi nuk është bindur ta heq dyshimin e bazuar ndaj tyre; prandaj duket se ka qenë i nevojshëm një version më me shumë ngjyra i rrëfimit. Gjykata është e sigurt se dëshmitarët vetëm kanë përshkruar një lloj të zakonshëm të granatës së dorës – e gjelbër, në formë limoni, dhe prerjet- dhe se ata nuk kanë parë asgjë tjetër sepse ajo nuk kishte ndodhur atë ditë. Pasi që ishte kohë lufte, nuk ishte vështirë që dëshmitarët të përshkruanin një shpërthim të granatës së dorës.

Gjithashtu vërehej se sa shumë dëshmitarë kanë pohuar se deklaratat e tyre dhënë Prokurorit nuk ishin të sakta dhe për çfarë arsyesh. Dëshmitarët B.Z. , J.R. dhe H.R. kanë pohuar se procesverbali i deklaratave të tyre dhënë Prokurorit ishin të jo të sakta; B. Z. madje pretendon se Prokurori ia kishte fabrikuar procesverbalin. Nuk ka pasur asnjë provë të vetme për këtë version, dhe shpjegimi se J.R. ka dhënë, gjegjësisht se ai vetëm kishte bërë një gabim, nuk ishte e besueshme, sepse megjithëse është normale të mos i kujtohet koha e saktë e arritjes së KFOR-it, njeriut i kujtohet qartë se a kishte qenë kjo në mëngjes apo në orët e vona të pasdites. Është normale vetëm se J. dhe H.R. nuk kishin pritur deri (vonë) pasdite që të largoheshin nga i kur H. synonte të ecte rrugës së gjatë deri në . Gjykata është e bindur se ata kanë tentuar t'i adaptojnë deklaratat e tyre që të bëjnë që Gjykata të besojë se J. ishte në tërë ditën dhe se ata e kishin parë atë.

Gjykata beson se J.B. ka treguar të vërtetën kur ka përshkruar rrugën e tij për në dhe se çka kishte ndodhur aty. Gjykata është dashur ta vlerësojë me kujdes besueshmërinë e J. dhe vlerën e deklaratës së tij nga pikëpamja e të gjitha provave të mbledhura. Ajo ka qenë e vetëdijshme se dënimi i tre të Pandehurve G. është në pjesët esenciale i bazuar vetëm në deklaratën e tij. Dëshmitari megjithatë nuk ka qenë as dëshmitar bashkëpunues, dhe as identiteti i tij nuk ka qenë anonim. Prandaj, kufizimet e parapara me Nenin 262.2 dhe 3. KPP nuk janë aplikuar.

J.B. ka ofruar shumë detaje siç është ngjarja me traktor që nuk ishte e domosdoshme të tregohet që të japë prova për rastin e vrasjes së G. dhe V.B. . Ishte i tërthortë në përshkrimin e rrjedhës së ngjarjeve, që faktikisht ka vërtetuar besueshmërinë e tij. Gjykata e gjen

gjithashtu të vërtetuar faktin se J. kishte takuar dëshmitarin Z.A. në banesën që e kishte braktisur një Serb në qendër të më , dhe jo ditë më vonë siç dëshmitari Z.A. dëshironte që Gjykata të besonte A. vetë e ka pranuar se ka pasur shumë shqiptar të Kosovës që menjëherë pas tërheqjes së Serbëve kërkonin banesë për ta uzurpuar, pasi që shumica e shtëpive të tyre ishin shkatërruar në njërin anë dhe kishte banesa që kishin mbetur nga Serbët që kishin ikur në anën tjetër. Kushdo që ka ardhur vonë ka rrezikuar të mos gjente më banesë. Duke e pasur këtë parasysh, ka kuptim që J.B. , siç ka thënë, ka provuar ta shikojë atë banesë sa më shpejt që ishte e mundur, përkatësisht në ditën e parë kur kishte arritur në , dhe jo disa ditë më vonë. Siç tashmë është thënë më lart, versioni i J. gjithashtu është më i besueshëm sepse takimi i papritur me dëshmitarin Z.A. nuk ishte i domosdoshëm për të përshkruar ngjarjet lidhur me vrasjet e G. dhe V.B. . Po ta kishte fabrikuar faktin se ishte në , nuk do ta kishte shpikur takimin me dëshmitarin Z. A. përveç se nëse do të ishte i sigurt se A. kishte konfirmuar deklaratën e tij. Një tregim i fabrikuar do të ishte zbuluar lehtë si gënjeshtër, sikur A. të kishte thënë se tërë ditën kishte qenë p.sh. në . Dëshmitari A. nuk ka shkuar aq larg. Ai nuk e ka mohuar ta ketë takuar J. , por ka tentuar që Gjykatën të bëjë të besojë se kjo kishte ndodhur më vonë, ashtu që nuk ishte dashur ta thotë një tregim plotësisht të pavërtetë. Është evidente se dëshmitari A. nuk e ka thënë të vërtetën në Gjykatë, sepse ai është në detyrë që në përgjithësi ofron një lloj besueshmërie, dhe ai është dashur ta dijë më së miri obligimet e tij në Gjykatë. Megjithatë, nga performanca e tij para Gjykatës është e qartë se rrëfimi i tij nuk ishte i saktë. Kjo u pa shumë qartë , kur ka thënë se e kishte parë të Pandehurin **H.G.** atë ditë në . Kur i Pandehuri **H.G.** në vend se ta pyeste dëshmitarin ka bërë një deklaratë para dëshmitarit dhe ka thënë se atë ditë kishte qenë në , dëshmitari pa menduar asnjë sekondë nëse dhe pse ka mundur të gabonte, ka korrigjuar veten dhe ka konfirmuar atë që i kishte i thënë H. , përkatësisht se e kishte parë H. në . Nga mënyra se si vepronte ishte e dukshme se kishte kuptuar se kishte bërë një 'gabim' në disfavor të të Pandehurit **H.G.** dhe me padurim donte ta korrigjojë atë. Gjykata nuk i ka besuar dëshmitarit.

Fakti që dëshmitarët tjerë si G.G. , L.G. , S.I. , M. dhe I.V. , Dr. B. M. dhe Dr B.G. nuk e kanë parë J.B. n atë ditë nuk do të thotë se ai nuk kishte qenë atje. J. vetë ka thënë se nuk ishte i sigurt se edhe Ganiu e kishte parë atë, dhe ai nuk ishte i sigurt nëse e kishte parë në të vërtetë Dr. B.G. . Ai megjithatë ka konfirmuar se e kishte parë L.G. që ishte qartazi një person i njohur mirë në Skenderaj me mjekër shumë gjatë L.G. ka konfirmuar se atë ditë kishte qenë në . Është normale që në një turmë të madhe në qendër të qytetit të njerëzit nuk e kishin parë apo nuk ju kujtohet se e kishin parë J. , sidomos për shkak se ai nuk kishte bërë asgjë të veçantë që do të bënte që njerëzit ta mbanin mend dhe në këtë kohë nuk ishte evidente se në mesin e një numri të madh dëshmitarësh në që do duhej të kishin bërë ndonjë lloj vështrimi sa u përket vdekjeve të G. dhe V. B. , J. do të ishte dëshmitari kyç në këtë rast pas vjetësh. Prandaj, nuk ka pasur nxitje që ndonjëri nga këta dëshmitarë ta mbante mend J. nëse kanë mundur ta shihnin atë në turmë.

Gjykata është e bindur se dëshmitarët, në veçanti pjesëtarët e familjes së gjerë B. , kanë harmonizuar deklaratat në dobi të të Pandehurve **G.** . Ata kanë mundur të veprojnë kështu që të mbronin veten dhe familjet e tyre. Të gjithë ata janë intervistuar për të parën herë vetëm pasi që të pandehurit **G.** ishin vënë nën masën e paraburgimit. E tërë familja B. ishte mjaftë e

vetëdijshme se jeta e J. , djemve të tij dhe gjyshes së tyre – të cilët që të gjithë janë tani në programin e mbrojtjes – ka ndryshuar dukshëm dhe se jeta e tyre nuk ishte siç kishte qenë para se J. kishte vendosur të dëshmojë. Kjo është arsyeja pse, kështu mendon Gjykata, E. B.

ka thënë se vëllai i tij është i çmendur dhe duhet të shkojë te mjeku. Ky koment i E. ishte i pabazuar dhe nuk ka reflektuar fare në përshtypjen që e kishte bërë dëshmitari para Gjykatës. Nuk kishte dyshim se gjendja mendore e J. ishte e qartë në mënyrë të përkryer. Gjykata nuk ka parë indikacionet më të vogla se zotësia njohëse e J.B. t i cili është person i arsimuar ka mundur të ishte e hendikepuar në ndonjë mënyrë në çfarëdo kohe. Në rastin e E.B.

ishtë më shumë se e dukshme se ai ishte i mërzitur për mungesën e nënës së tij e cila kishte shkuar jashtë vendit me djalin e saj më të ri J. dhe për atë e kishte fajësuar J. .

Gjykata është e sigurt se ka pasur presion të lartë në të gjithë dëshmitarët në këtë rast për të mos dëshmuar kundër të Pandehurve **G.** si ish pjesëtarë të UÇK-së. Është konfirmuar nga vetë dëshmitari J.B. në të gjitha mediat në Kosovë, se ka pasur poster të tij të ngjitur në komunën e . Në postera thuhej se J. po tradhtonte luftën e shenjët të UÇK-së. Kjo tregon se çka do mund t'i ndodhte çdonjërit që do guxonte të jepte deklaratë në disfavor të ish pjesëtarëve të UÇK-së. Ai apo ajo do të ishte së pakut në rrezik që të paraqitet në publik në mënyrën më të degraduar. Sidoqoftë, presioni shoqëror që të mos dëshmohet kundër pjesëtarëve të UÇK-së është jashtëzakonisht i lartë. Gjykata për këtë i referohet vlerësimeve të mëparshme të Gjykatës së Apelit në aktvendimet e saj për paraburgimin ( shih Aktvendimin e datës 22 Shkurt 2013, Kp 117/13).

#### 4.2. Ngjarjet në rrugët e dhe në qendrën mjekësore

Gjykata gjithashtu është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** kanë vlarë G.B. në qendrën mjekësore; është vërtetuar se Ganiu nuk ishte vlarë në rrugë.

4.2.1. Dëshmitari J.B. ka përshkruar ngjarjet pas të shtënave në rrugë kur ishte qëlluar V. si vijon: Pas të shtënës së parë ai nuk ka ndenjur në vend por ka ecur nga aty. Ai as nuk i kishte parë viktimat më në rrugë as nuk kishte parë se si kishin arritur ata në qendrën mjekësore. Ai dhe vëllai i tij pastaj kishin shkuar në spital për të parë se çka kishte ndodhur përfundimisht sepse ishin kureshtar; shumë njerëz kishin vepruar ashtu. Ai nuk e kishte ditur saktësisht se sa kohë kishte kaluar pas të shtënave të cilat e kishin qëlluar G. dhe V. deri sa ai kishte vendosur të hynte në qendrën mjekësore. Ka mundur të ishte rreth - minuta por nuk ishte i sigurt. Pasi kishte arritur në qendrën mjekësore, aty në korridor tashmë ishin grumbulluar shumë njerëz. Ai mendon se ka mundur ta ketë parë Dr. B.G. aty pari por nuk i kujtohet saktësisht dhe nuk mund të thoshte nëse i kishte parë të Pandehurit **G.** mu në atë moment kur kishte arritur në korridor. Pastaj papritmas kishte dëgjuar një rafal të shkurtër të shtënash që po vinin nga dhoma e e cila gjendej afër hyrjes në katin përdhes të ndërtesës; ai kishte qenë vetëm disa metra larg nga kjo dhomë. Ai nuk kishte parë se çka kishte ndodhur brenda. Ai vetëm kishte parë menjëherë të tre të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** që po dilnin nga dhoma. Ata të gjithë ishin të armatosur dhe kishin dalë përmes derës së daljes së qendrës mjekësore. Me që dera e dhomës së ishte e hapur, ai dhe njerëzit tjerë ishin afruar dhe kishin shikuar brenda. Në dhomë kishte parë dy njerëz të shtrirë në dy shtretër njëri pran tjetrit. Ata ishin të mbuluar me gjak.



Brenda në dhomë ishte edhe i Pandehuri **Dr Sh.** i cili ishte tërësisht i shtangur dhe po mbante kokën me duar. Dëshmitarit nuk i kujtohej saktësisht nëse kishte folur me mjekun mu në këtë moment apo jo. Ai nuk kishte qëndruar më gjatë dhe ishte larguar nga qendra mjekësore me vëllain e tij Xh. ; pastaj ishin kthyer në shtëpi në . Kur kishin arritur aty ishte errësuar.

Ai nuk kishte folur me anëtarët e familjes për atë që kishte parë lidhur me vrasjet sepse, siç ka deklaruar, ishte shumë e rrezikshme. Të vetmet biseda që i kishte pasur kanë qenë biseda të përgjithshme me shokë lidhur me atë se kush ishte vrarë dhe pse. Disa vjet më vonë ai kishte pasur edhe një bisedë të shkurtër me të Pandehurin **Dr. Sh.** i cili dikur ishte shok i tij. **Dr. Sh.** atëherë i kishte thënë se kishte provuar t'i ndalte të Pandehurit që të mos e vrisnin një rën viktimë që nuk kishte vdekur, por vetëm plagosur, por nuk ka mundur ta bënte atë. I Pandehuri **Dr. Sh.** nuk kishte dashur të hynte më thellë në këtë temë.

Pala e Dëmtuar dhe Dëshmitari M.V. ka thënë Gjykatës se kur ishte qëlluar, ai i kishte parë edhe G. dhe V. të shtrirë në tokë rreth - m larg tij. Atij iu kishte dashur rreth minuta që të gjente ndihmë për vëllain e tij I. . Ai kishte parë të dy trupat e shtrirë në tokë kur ishte larguar për në qendrën mjekësore dhe gjithashtu kur ishte kthyer në vendin ku ata ishin akoma aty . Kur kishte ardhur vetura e ambulancës, atyre iu kishin nevojitur edhe 20 minuta tjerë deri sa ishin larguar nga vendi i ngjarjes. Ai prapë kishte parë dy trupat që ende ishin të shtrirë në tokë ku askush nuk po qëndronte afër tyre.

Pala e Dëmtuar dhe Dëshmitari I. V. nuk ka mundur të jepte informata të sakta lidhur me atë se kush dhe sa kohë kishte qenë afër tij, sepse ai ishte larguar nga vendi ku ishte shtënë në të dhe më vonë i kishte humbur vetëdija.

Dëshmitari Dr. B.M. – mjek në qendrën mjekësore në në vitin - më kishte dëgjuar se qyteti ishte çliruar dhe ai gjithashtu kishte dalë nga qendra mjekësore për të festuar. Ai pastaj kishte takuar te porta e qendrës mjekësore M.V. i cili kishte kërkuar nga ai t'i ndihmonte vëllait të tij I. që ishte i plagosur rëndë. Kur ai po shkonte pas M. kishte parë dy trupat e shtrirë në tokë. Ai kishte menduar se ishin të vdekur; ai pastaj kishte vazhduar në drejtim të ndërtesës së . Kur është pyetur pse nuk ishte ndalë për ta verifikuar vdekjen e personave ai ka thënë se nuk e ka parë të arsyeshme ta bëjë atë meqë ata ishin të vdekur dhe nuk kishte nevojë të kontrolloheshin personat e vdekur. Pastaj ai dhe KFOR-i i kishin dhënë ndihmën e parë I.V. dhe kishin përgatitur një infuzion për të. Ai ka thënë se ata është dashur të kenë qëndruar një kohë bukur të gjatë në atë vend. Kishte kaluar gati një orë deri sa kishte arritur vetura e ambulancës me dëshmitarin Q.A. si shofer. Atij i kujtohet se një nga infuzionet që i kishin dhënë atij pothuajse kishte përfunduar deri atëherë. Kur ishte larguar nga ai vend me ambulancë ai akoma kishte parë trupat e dy personave në tokë për të cilët ka supozuar se ishin të vdekur.

Dëshmitari Q.A. – ngasës i ambulancës në qendrën mjekësore të Skenderajt - ka thënë se ai kishte qëndruar brenda qendrës mjekësore ku ai punonte dhe gjithashtu jetonte gjatë luftës. Dikur pas-dite dikush e kishte thirrur atë që të shkonte të merrte një person të lënduar para Gjykatës. Menjëherë kishte shkuar atje, nuk i kujtohet nëse ka shkuar i vetëm apo së bashku me dëshmitarin Dr. M. . Vendi ku ata e kishin gjetur të lënduarin ishte rreth m larg qendrës mjekësore. Ai e kishte futur personat e lënduar në veturën e ambulancës dhe i kishte dërguar në spitalin e përmes një vendi të quajtur . Kur kishin arritur në tashmë ishte errësuar. Ai

nuk kishe kaluar shumë kohë në vendin ku i kishte gjetur viktimat e lënduar, por vetëm kohën që nevojitej për t'i ngritur ata dhe për t'i futur në ambulancë; pastaj ishin larguar. I pyetur rreth trupave të G. dhe V.B., dëshmitari nuk ishte i qartë. I pyetur disa herë nëse i kujtohej se sa persona i kishte parë mbi tokë jo larg nga I. dhe M. ai ndryshoi; fillimisht ai kishte thënë se deklarata e tij për Prokurorin ishte e saktë, kishte parë një person. Kur u pyet nga Avokati Mbrojtës Rrecaj nëse ai mund vizatonte një skicë dhe të tregonte se ku ishin të shtrirë të dy personat (G. dhe V.), ai ka thënë se të dy ata ishin të shtrirë në një pikë të caktuar që e kishte shënjuar në skicë. Ku u pyet nga Avokati Mbrojtës Mahmut Halimi nëse ai ende kishte parë të dy trupat kur u larguan për në , dëshmitari kishte thënë se atij i dukej se ata ende ishin aty. Kur u rikujtua nga Kryetari i Trupit Gjykues se deklarata e tij ndryshon lidhur me numrin e personave që kishte parë, ai korrigjoi vetën dhe tha se pasi që shumë njerëz po mblidheshin në vend, në fakt nuk mund të shihej se çfarë po ndodhte. Në përgjithësi ai konfirmoi se qendra mjekësore nuk kishte morg dhe nëse një person do të vdiste, personi do të vendosej kudo që kishte vend.

Dëshmitari N.B. – nip i të ndjerëve G. dhe V.B. - i kishte deklaruar Gjykatës se më , pasi që e kishte parë axhën e tij, V., të shtrirë i vdekur në rrugë në pikën A (shih deklaratën më lartë), ai kishte ecur rrugës në një pikë të shënjuar me E. Duke ecur rrugës së tij ai kishte parë dy persona të veshur në të zezë duke hyrë në qendrën mjekësore; ata ishin të armatosur me pushkë kalashnikovi të cilat po i mbanin. Njërin nga ta, N. e identifikoi të jetë **S.G.** i cili po ngiste dhe kishte në pronësi një veturë të . Vetura ishte parkuar afër udhëkryqit para se ai, N., të arrinte në pikën A. Ai e dalloj **S.G.** pasi që e njihte shumë kohë para . Vetura e kuqe i **S.G.** ishte vetura e vetme në gjatë luftës. **S.G.** kishte të veshur rroba të zeza si ato të ushtrisë apo policisë. Në krahun e tij kishte një emblemë që lexonte “ ”. Me të, ai kishte parë një person tjetër me flokë të shkurtër ngjyrë hiri apo biond në mes të tridhjetave i gjatë rreth - m. Pastaj i kishte dëgjuar të shtëna nga brenda spitalit por që nuk mund të ofronte detaje më të hollësishme. Ai nuk kishte parë **S.G.** apo të Pandehurit e tjerë duke dalë jashtë qendrës mjekësore atë ditë. Pak kohë pas të shtënave i kuq kishte lëvizur me shpejtësi të madhe dhe kishte bërë kthesë në të djathtë në pikën F. **S.G.** ishte duke e ngarë atë; dëshmitari nuk ishte i sigurt nëse kishte më shumë persona brenda. Ai nuk ishte i sigurt nëse i kishte parë të Pandehurit H. dhe **Rr. G.** atë ditë, por i kishte parë dëshmitarët S.I. dhe L.G. .

Dëshmitarja K.Xh.B. - palë e dëmtuar dhe e veja e të ndjerit V.B. – ka dëshmuar për atë se çfarë kishte ndodhur pas vrasjes së G. dhe V. . Ajo ka deklaruar se më , dikur vonë por para lindjes së diellit, në shtëpinë e saj kishte ardhur fqinji i saj I.T. dhe i kishte treguar se G. dhe V. ishin vrarë. Dëshmitarja K. menjëherë kishte shkuar te qendra mjekësore për të mësuar se çfarë kishte ndodhur por iu është dashur të kthehej sepse ishte errësuar. Mëngjesin tjetër ajo ishte zgjuar në ora të mëngjesit dhe nuk mund të flinte. Prapë kishte shkuar në qendrën mjekësore. Përballë ndërtesës ajo kishte takuar një plak të quajtur N., i cili beson që tanimë ka vdekur. N. i kishte thënë asaj se një nga dy burrat që ishin vrarë një ditë më parë, kishte vdekur në vend dhe tjetri kishte ecur brenda qendrës mjekësore. Kur ajo kishte arritur në qendrën mjekësore, në katin ku gjendej reparti i , ajo kishte takuar dëshmitarin F.O. . F. fillimisht kishte menduar se ajo po pyeste për vëllezërit V. [I. dhe M.] që ishin të plagosur. Pasi që i kishte treguar se kush ishte, F. i kishte thënë asaj se të dy ishin të vdekur dhe se ishin vrarë. Ai gjithashtu i kishte treguar se trupat ishin dërguar diku jashtë qendrës mjekësore, dhe më pas i kishte treguar vendin se ku ishin dërguar. Ishte përballë

qendrës mjekësore, në kuadër të repartit të . Dera e dhomës ku ishin vendosur trupat ishte e mbyllur me çelës dhe ata nuk e kishin çelësin. Prandaj, dëshmitares K. iu kishte dashur të shkonte prapë në shtëpi. Kur u rikthye më vonë atë ditë, në objektin e qendrës mjekësore kishte takuar Dr. R.M. së bashku me të Pandehurin **Dr. B.Sh.** . Doktorët nuk ishin të gatshëm t'i jepnin K. ndonjë informatë për atë që kishte ndodhur. Ajo e kuptoi atë, si ishte shprehur ajo, gjërat nuk ishin në rregull, dhe ajo supozonte se ose doktorët ishin të kërcënuar ose nën trysni. Ajo kishte parë se i Pandehuri **Dr. Sh.** ndjehej jo rehatshëm.

Pastaj ata ishin kthyer në repartin e pediatriisë; Dr M. i kishte thënë dëshmitares që as të mos qante me zë e as të mos bërtiste. Ai pastaj e kishte hapur derën dhe dëshmitarja kishte hyrë. Doktorit qëndronte te pragu i derës dhe kishte kërkuar që ajo të ngutej. Asaj i kujtohet se e kishte parë G. dhe V. si "katastrofë". Të dy ishin të shtrirë në dysheme. G. ishte plot gjak, kishte fasha në krahun e majtë dhe një kateter për shishe infuzioni. Sa i përket V. , asaj i kujtohej vetëm një plumb në anën e prapme të kokës së tij sepse kishte shumë gjak në atë vend. Ajo nuk ishte e sigurt nëse ishte qëlluar në trup. Më vonë, familja i kishte marrë trupat dhe i kishte varrosur ata. Dëshmitarja nuk kishte shkuar në polici për të nisur hetimet sepse kishte frikë ta bënte atë.

Dëshmitarët F.O. , Z.D. , Dr. B.G. dhe A.L. nuk ishin në gjendje të japin informata relevante lidhur me vrasjet si të tilla dhe të gjithë ata pretendojnë se nuk kishin qenë në vend të ngjarjes kur kishin ndodhur të shtënat. Dëshmitarët D. dhe Dr.G. kanë deklaruar se ata nuk kanë qenë në detyrë atë ditë ( ) që përputhet me orarin e punës së qendrës mjekësore të siguruar nga i Pandehuri **Dr. Sh.** . F.O. dhe A.L. kanë thënë se ata kishin qenë në qendër mjekësore por se nuk kishin vërejtur asgjë. F.O. i ka dhënë deklaratë policisë se njerëzit në thoshin se një viktimë ishte vrarë në qendrën mjekësore dhe ata e pyesnin nëse kishte informata më të hollësishme. Kur është pyetur prapë në Gjykatë lidhur me atë se për çka po flisnin njerëzit, ai kishte thënë se askush nuk e kishte pyetur atë dhe se nuk dinte asgjë. I Pandehuri **Dr. Sh.** kishte dhënë deklaratë më kur ishte në rolin e dëshmitarit se ai nuk kishte parë asgjë (shih të detajuar më poshtë nën pikën 6.).

4.2.2. Vlerësim: Gjykata ka konkluduar drejtpërdrejtë nga deklaratat e dëshmitarëve J.B. dhe K.Xh.B. dhe tërthorazi nga deklaratat e personelit shëndetësor të qendrës mjekësore të se G.B. nuk ishte vrarë kur në të është shtënë në rrugë por se ai ishte ekzekutuar në qendrën mjekësore nga të Pandehurit **G.** .

Nuk ishte vendimtare se në fazën e provave të shqyrtimit gjyqësor nuk do të mund të zbulohet në çfarë mënyre dhe gjatë cilit afat kohor kishte arritur V. dhe G. në dhomën e emergjencës të qendrës mjekësore të . Gjykata nuk e ka konsideruar relevante faktin që dëshmitari J.B. nuk kishte mundur ta përshkruaj saktësisht se sa kohë kishte kaluar ndërmjet të shtënës së parë në rrugë deri sa kishte hyrë në qendrën mjekësore. Është normale që kujtesa e një dëshmitari dështon kur kemi të bëjmë më afatin e saktë kohor në minuta pasi të kenë kaluar vite. Ky në veçanti është rasti pasi që J. nuk ka mundur të dijë pas asaj që kishte parë në rrugë se çka do të ndodhte në qendrën mjekësore dhe më pastaj nuk ka pasur nxitje për ta mbajtur mend kohën e saktë ndërmjet ngjarjes së parë dhe të dytë. Prandaj, koha ka mundur të jetë më e gjatë apo më e shkurtë. Me rëndësi është se çka kishte parë dëshmitari në qendrën mjekësore.

Fakti që G. dhe V. në një moment kishin arritur në qendrën mjekësore është i pakontestueshëm. Edhe duhet të ketë pasur shumë dëshmitar okular brenda turmës që kishin parë

se si G. dhe V. kishin arritur apo ishin transportuar nga rrugët, asnjë nuk kemi mundur ta gjejmë apo nuk është paraqitur si vullnetar për të dhënë deklaratë është e pazakontë. Zakonisht, në rast të vrasjeve në publik, shumë dëshmitarë paraqiten dhe i japin policisë informata të rëndësishme dhe më pak të rëndësishme. Ky nuk ishte rasti në në fund të luftës kur ishin vrarë dy bashkëpunëtor të pretenduar të Serbëve. Sipas kompetencës së saj nga Neni 329.4 KPP Gjykata ka tentuar të shikoj nëse ka ndonjë raport të shkruar nga KFOR-i me qëllim që të marrin më shumë prova në këtë drejtim. Rezultati ishte se nuk kishte raport të KFOR-it (shih procesverbalin e seancës së shqyrtimit gjyqësor të datës 4 Shtator 2013). Pasi që disa dëshmitarë e kishin parë vetëm V. të shtrirë në toke e jo edhe G., Gjykata beson se edhe G. do duhej të kishte ardhur në qendrën mjekësore pak kohë pasi që V. ishte sjellë në qendrën mjekësore. Kjo ka mundur të jetë brenda - minutash, ashtu si ka thënë dëshmitari J.B., apo pak më heret apo pak më vonë sepse J. nuk ishte i sigurt për periudhën kohore.

Gjykata konstaton se deklaratat e J.B. është e besueshme. Ajo ka qenë e detajuar dhe gjithashtu koherente. Në vlerësimin e besueshmërisë së tij Trupi Gjyqësor ka marrë të rëndësishme ekzaminimin e tij para Gjykatës kur ka dhënë deklaratën për një ditë e gjysmë. Gjykata dhe të gjitha palët kanë pasur rastin ta vështrojnë fytyrën e tij, mimikën dhe gjestet dhe mënyrën në të cilën dëshmitari iu kishte përgjigjur pyetjeve. Ishte e dukshme se në fillim të seancës së parë të shqyrtimit gjyqësor ai ishte nervoz dhe frikohej se deklaratat e tij mund të transmetohej nga media. Vetëm pasi i është thënë se media nuk ishin prezentë në sallën e gjyqimit ai ishte qetësuar ngadalë. Gjykata ka konstatuar se Dëshmitari kishte dhënë deklaratën në mënyrë të rrjedhshme, konstante dhe shumë bindëse. Ai u ishte përgjigjur pyetjeve p.sh. lidhur me çështjet që nuk ishin direkt të lidhura me vrasjen por me çështjet personale në mënyrë të njëjtë rrjedhëse dhe të drejtpërdrejtë sikur që iu kishte përgjigjur pyetjeve lidhur me detajet e rastit. Ai ishte i kujdesshëm dhe i vetëdijshëm, nuk hezitonte të tregonte kur nuk ishte i sigurt lidhur me detajet e caktuara apo thjeshtë nuk i kujtoheshin më. Kur bënte pauza, atëherë linte përshtypjen se përqendrohej për t'i rikujtuar detajet. Dëshmitari gjithashtu i ka treguar Gjykatës gjërat që mund të vlerësoheshin në disfavor të tij si ajo që ai dëshironte të uzurponte ilegalisht banesën e Serbit. Trupi Gjyqësor ka konstatuar se ky ishte faktor i rëndësishëm për besueshmërinë e deklaratës së tij. Ai erdhi në përfundim se dëshmitari kishte treguar të vërtetën.

Motivi pse dëshmitari J. kishte shkuar në qendrën mjekësore dukej të ishte befasues në momentin e parë, por shpjegimi i dëshmitarit se kishte edhe njerëz të tjerë që gjithashtu po e përcillnin, ishte bindëse. Për të gjithë njerëzit e pranishëm ishte fare e qartë përse ishte shtënë në vëllezërit B., përkatësisht për shkak se ata ishin bashkëpunëtorë, dhe kjo ishte arsyeja pse njerëzit nuk kishin pse të frikoheshin që do të shtihej në ta. Kjo vetëm tregon se të Pandehurit G. nuk frikoheshin nga dëshmitarët okularë në atë kohë sepse ata e dinin se asnjëri nuk do të paraqitej vullnetar për të dëshmuar kundër tyre gjë të cilën njerëzit nuk e kishin bërë për vite.

Ishte gjithashtu i parëndësishëm fakti që J. në deklaratën e tij nuk kishte përmendur se i kishte parë Palët e Dëmtuara I. dhe M.V. atë ditë që për Mbrojtjen ishte një shenjë në mes tjerash se J. fare nuk ka mundur të jetë në . M. dhe I. ishin duke u larguar nga vendi ku ishin qëlluar dhe kur I. ishte rrëzuar në tokë disa metra larg ndërsa M. kishte tentuar të kërkojë ndihmë. Dëshmitarët vetë nuk ishin të qartë lidhur me vendin e saktë se ku ishin qëlluar dhe dallonin në deklaratat e tyre. Në gjithashtu ishte një turmë e madhe që pengonte shikimin në atë që u kishte ndodhur M. dhe I. Sa i përket kësaj, vlen të theksohet se

Palët e Dëmtuara dhe dëshmitari Q.A. mezi ishin përkujdesur për G. dhe V. dhe A. ka deklaruar se aty ishte një turmë e madhe që pengonte pamjen. Përfundimisht, J. nuk kishte mbetur në atë vend ku kishte qenë dëshmitar i të shtënave në rrugë por menjëherë ishte larguar për pak kohë. Andaj, nuk është përfundim i obligueshëm se ai është dashur ta kishte parë I. dhe M. kur ishin qëlluar dhe kur merrnin ndihmën e parë, sidomos nëse J. kishte qenë tashmë në qendrën mjekësore dhe kishte vërejtur ngjarjet lidhur me G.B.

Me qëllim të vërtetimit të besueshmërisë së J. Gjykata gjithashtu ka vlerësuar me kujdes të gjitha deklaratat që ai ia ka dhënë Prokurorit në fazën e procedurës paraprake. Ajo vë në dukje se në deklaratën e tij të parë dhënë Prokurorit më dëshmitari kishte dhënë një version të shkurtë të ngjarjeve:

*“Unë dhe disa njerëz tjerë kemi shkuar pas të vdekurit dhe të plagosurit derisa ata po i bartnin disa kalimtar për në qendrën mjekësore, që ishte m larg. Të tre G. gjithashtu u shkonin pas atyre me armë. Kur kishin arritur aty, ata kanë dashur të hynin në qendrën mjekësore. Personeli mjekësor përfshirë Mjekun B.SH. , kishin tentuar t’i ndalonin që të mos hyjnë, por ata të tre i kishin larguar duke i shtyrë. Ata kishin hyrë në ndërtesë dhe pak kohë më pastaj kam dëgjuar të shtënat që ishin shkrepur. Menjëherë pas kësaj, kam parë ata të tre duke dalë nga qendra mjekësore, ende duke bartur armët. Menjëherë pas kësaj, kam mësuar se të plagosurit ishin vrarë brenda në qendrën mjekësore dhe para personelit mjekësor”.*

Trupi gjykues nuk ka konstatuar se version i ngjarjeve ka prishur besueshmërinë e dëshmitarit. Ai haptazi dhe pa hezitim kishte korrigjuar përshtypjen që ka mundur të dilte nga deklarata e tij, përkatësisht se a i kishte parë të Pandehurit duke hyrë, dhe ka sqaruar se ai vërtetë nuk kishte parë se në ç ’mënyrë kishin arritur G. dhe V. në qendrën mjekësore. Ai ka dhënë shpjegim të besueshëm se deklaratat e tij të mëparshme, sidomos deklarata e parë, ishte vetëm deklaratë e përgjithshme. Ai e ka pranuar se në kuadër të kësaj përmbledhjeje të shkurtë ai kishte përmbledhur gjërat që kishte dëgjuar nga të tjerët dhe kishte përzier gjërat që kishte ardhur në përfundim dhe që i kishte parë më sytë e tij.

Ky shpjegim ishte bindës sepse J. më ishte thirrur për të dhënë dhe kishte dhënë një deklaratë për një rast tjetër. Ai vetëm spontanisht kishte raportuar për vrasjet e G. dhe V.B. . Ai as nuk është pyetur më shumë për detajet dhe as deklarata në përgjithësi nuk ishte shumë e gjatë. Intervista e procedurës paraprake kishte filluar në ora dhe kishte përfunduar në ora dhe prandaj kishte zgjatur orë e minuta. Procesverbali përmban gjithsej faqe e gjysmë. Ngjarjet lidhur me të Pandehurit G. ishin mbuluar me rreth një gjysmë faqeje nga gjithsej 5 faqe e gjysmë. Prandaj, shpjegimi i dëshmitarit se ai vetëm kishte dhënë një përmbledhje të ngjarjeve si i tillë ka kuptim. Është gjithashtu e qartë se procesverbali nuk ishte marrë fjalë për fjalë. Fakti që J. në deklaratat e mëparshme kishte përzier vrojtimit dhe konkludimet gjithashtu mund të konsiderohet si një sjellje jo atipike e dëshmitarit, në veçanti pasi kishte kaluar një kohë e gjatë. Pasi që J. kishte parë të Pandehurit G. në qendrën mjekësore, ata logjikisht është dashur të kenë hyrë në një moment.

Duke pasur parasysh principet madhore të ri kujtesës së dëshmitarit, Gjykata gjithashtu nuk ka interpretuar mospërputhje tjera të vogla në disfavor të dëshmitarit. Është jo relevante nëse dëshmitari kishte hyrë në dhomën e emergjencës duke futur njërën këmbë në hyrje apo nëse kishte

hyrë plotësisht apo vetëm kishte futur kokën. E njëjta gjë vlen për faktin se a iu kishte drejtuar mjekut me ndonjë pyetje apo jo. Nga këndvështrimi i dëshmitarit këto detaje ishin të rëndësishme së vogël. Prapë është normale pas kalimit të kohës së gjatë që kujtesa e dëshmitarit ka ruajtur vetëm fotografinë e viktimave që ishin shtrirë në shtrat dhe të mjekut të tmerruar që po mbante kokën dhe që ai nuk kishte memorie të saktë për detajet tjera që, nga pikëpamja e tij kanë mundur të mos jenë të rëndësishme. Kur është ekzaminuar para Gjykatës ai qartazi ka treguar në cilat pjesë të deklaratave të tij të mëparshme nuk ishte më saktësisht i sigurt, si nëse e kishte parë Dr B.G. apo nëse vërtetë i kishte parë të pandehurit **G.** duke hyrë në dhomën ku kishin qenë G. dhe V. . Gjithashtu është normale që në këtë deklaratë ai ka thënë se kishte mësuar se i plagosuri (G. ) ishte vrarë brenda në qendrën mjekësore, sepse ai nuk kishte qenë brenda në dhomë dhe nuk ka mundur të dijë kur kishte dëgjuar të shtënë se në çfarë gjendje ishte G. , dhe nëse të shtënë kishin rezultuar (në mënyrë të suksesshme) me vrasje apo jo.

Gjykata ka përjashtuar mundësinë se J. nuk ka qenë i pranishëm fare në qendrën mjekësore dhe vetëm ka treguar një rrëfim që bazohet në thashetheme në . Është e qartë se nëse J.

nuk kishte qenë në qendrën mjekësore, nuk kishte pasur kuptim që ai ti tregonte Prokurorit apo Gjykatës së kishte parë të Pandehurin **Dr. B.Sh.** . Po të kishte fabrikuar J. rrëfimin dhe **Dr. B.Sh.** thjeshtë të mos kishte qenë në qendrën mjekësore, p.sh. për shkak se nuk kishte qenë ditë pune për të, rrëfimi do të prishej. Të gënjerit sa i përket kësaj do të kishte krijuar një rrezik tjetër të panevojshëm që një rrëfim i fabrikuar të zbulohet. Gjithashtu nuk kishte motiv të dukshëm pse J.B. do të kishte përfshirë të Pandehurin **Dr. Sh.** në rrëfimin e fabrikuar, nëse **Dr. Sh.** nuk kishte qenë aty.

Gjykata është bindur se **H.** dhe **Rr.G.** kishin qenë me **S.G.** kur kishte ndodh vrasja në qendrën mjekësore, edhe pse dëshmitari N.B. kishte parë vetëm S. dhe një person të panjohur që po hynin aty. Ashtu siç ka thënë vetë dëshmitari N.B. ai kishte shikuar vetëm kalimthi se çka po ndodhte para qendrës mjekësore. Meqë në rrugët e kishte turmë njerëzish, **H.** dhe **Rr.** është dashur të kenë qenë tashmë brenda apo të kenë ardhur pak më vonë se S. . Dëshmitari J.B. , siç e pranon vetë, nuk i kishte parë ata duke hyrë. Gjykata e gjen vendimtar faktin se ai i kishte parë të tre të Pandehurit menjëherë pas të shtënave.

Nuk ka dyshim se J. i kishte njohur **S.** , **R.** dhe **H.G.** të cilët i kishte njohur për një kohë të gjatë dhe të cilët i kishte identifikuar drejtë.

Përfundimisht, nuk kishte dyshim se G.B. ishte vrarë brenda në qendrën mjekësore gjë që vërteton deklaratën e J.B. t. E tërë sjellja e mjekëve dhe e stafit mjekësor në qendrën mjekësore nuk do mund të jetë e shpjgueshme, nëse të dy vëllezërit B. ishin sjellë në qendrën mjekësore të vdekur. Në këtë rast, **Dr Sh.** , F.O. apo të tjerët të cilët kanë qenë duke punuar në atë ndërrim atë ditë kanë mundur lehtë të thoshin ashtu pa qenë të komprometuar në çfarëdo mënyre. I njëjtë do të ishte rasti nëse G.B. ishte sjellë i plagosur rëndë në qendrën mjekësore dhe ai thjeshtë kishte vdekur aty për shkak të ndonjë lëndimi të rëndë. Stafi mjekësor megjithatë nuk ka vepruar ashtu. I pandehuri **Dr. Sh.** dhe Dr. R.M. kanë shmangur bisedën me dëshmitaren K.Xh.B. . Dr. M. e ka lejuar atë që shpejtë t'i shihte viktimat dhe pastaj e kishte nxitur atë t'i merrte trupat me vete sepse donin të hiqnin trupat qafe; askush nuk donte të përfshihej në rast. Arsyeya pse kishin vepruar ashtu është shpjeguar në mënyrë të përkryer

nga K. : I tërë personeli mjekësor përfshirë të Pandehurin **Dr. Sh.** e dinin se çka kishte ndodhur dhe frikoheshin shumë ta thoshin të vërtetën.

Gjykata ka konstatuar se asnjë nga deklaratat e lartëcekura të stafit mjekësor nuk ka prishur konstatimet e Gjykatës se G. ishte ende gjallë kur kishte arritur në qendrën mjekësore. Deklaratat e Dr. M. dhe e M.V. në këtë drejtim ishin të dyshimta kur theksonin një kohë shumë të gjatë se dy persona ishin të shtrirë në tokë; Trupi Gjykues është i bindur se ata ose gabimisht kishin parë dy persona në tokë sepse e tërë vëmendja e tyre ishte fokusuar në të plagosurin e rëndë I.V. , ose qëllimisht nuk i kishin thënë Gjykatës të vërtetën. Dëshmitari Dr. M. i ka lënë përshtypjen Gjykatës në ekzaminimin e tij se ai nuk i kishte thënë të gjitha gjërat që ai i dinte dhe në çdo mënyrë është shmangur që t'i ndihmojë Gjykatës ta gjejë të vërtetën. Deklarata e tij se KFOR-i dhe ai për një kohë të gjatë i kishin dhënë ndihmën e parë dhe shishja e infuzionit ishte thuajse e zbrazur që zakonisht zgjatë rreth një orë, nuk është e besueshme. Ambulanca ishte në qendrën mjekësore dhe nga aty është e pamundur që t'i duhej një orë për të arritur në vend nga një distancë prej - m dhe gjithashtu nuk është e besueshme se ajo është thirrur vetëm pas një kohe kaq të gjatë. Pasi që Dr. M. e dinte se kolegu i tij profesional **Dr. Sh.** të cilin e kishte parë në bankën e të Pandehurit ishte akuzuar, Dr. M. kishte arsye ta mbronte veten duke thënë se të dy personat ishin vrarë në rrugë. Vetëm duke deklaruar kështu ai mund t'i shmangej të dyshimit për dhënie të deklaratës së rreme, ose, për dështim të përmbushjes së standardeve etike mjekësore. Nëse ai, si doktor kishte parë një person të plagosur dhe nëse nuk do të kishte iniciuar ndonjë ndihmë mjekësore, ka mundur të ketë shkelur detyrimet e tij profesionale dhe betimin mjekësor.

#### 4.3. Ngjarjet në (Alibitë)

Mbrojtja në një propozim të përbashkët të propozuar për të dëgjuar disa dëshmitar si dëshmitarë alibie për të Pandehurit **S.G.** dhe **Rr.G.** me qëllim që të dëshmonin se këta kishin qenë në , një fshat afër më dhe jo në qytetin e Skenderajt ku kishin ndodhur vrasjet.

##### 4.3.1. I Pandehuri **S.G.**

Dëshmitari H.G. – axhë i të Pandehurit **S.G.** – kishte dhënë dëshminë se më kishte mësuar së pari herë se ishte çliruar dhe një ditë më vonë disa kushërinj i kishin treguar se gjithashtu ishte çliruar. Ai po kthehej në një datë që atij nuk i kujtohej saktësisht për të kontrolluar shtëpinë që ishte djegur. Ata kishin për qëllim ta riparonin atë. Ai kishte punuar së bashku me të Pandehurin **S.G.** . Fshatarët dhe ushtarët e UÇK-së i kithin thënë atij në mëngjes së forcat serbe ishin larguar nga fshati, pra se mund të lëviznin pa rrezik. Kur ata kishin shkuar në shtëpi nuk kishin pajisje me vete. Ai dëshironte të shihte se çka kishte mbetur nga shtëpia dhe nëse ata do bënin ndonjë riparim. Ata kishin filluar ta riparojnë kulmin. Ai dhe **S.G.** kishin ndenjur në shtëpi dhe nuk kishin dalë gjatë tërë ditës. Atë ditë, po bëhej shumë punë sepse njerëzit kishin dëgjuar se çka kishte ndodhur dhe ishin kthyer në shtëpitë e tyre dhe po flisnin me njëri tjetrin. Ai theksoi se **S.** e kishte si djalë të vetin.

Dëshmitari Xh.J. – kusheri i largët i **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** – ka dëshmuar para Gjykatës se ai kishte kuptuar nga njerëzit që vinin nga se qyteti ishte çliruar me datën . Ai ka thënë se kjo kishte ndodhur në orët e hershme të pasdites, pas orës . Ai ka konfirmuar se shtëpia e **S.G.** ishte shkatërruar gjatë luftës. Ai e kishte takuar atë , pasditen e datës

jashtë shtëpisë së tij, pasi që kishte kuptuar se Skenderaj ishte çliruar. Ata kishin folur për rreth një orë lidhur me vendndodhjen e fëmijëve të tyre, por jo për çlirimin e . Ata kishin qëndruar së bashku deri vonë pasdite. Kjo dallon nga deklaratat që i kishte dhënë Prokurorit më , kur duke u përgjigjur në pyetjet Nr. dhe kishte thënë se më ishte larguar nga për në fshatin e tij rreth orës - pas dite për tu takuar me familjen e tij. Distanca ndërmjet dhe është rreth km.

I Pandehuri **S.G.** ka dhënë një deklaratë në lëndën e tij dhe i referohet dëshmisë së tij të dhënë në fazën e procedurës paraprake më . Ai ka refuzuar tu përgjigjej pyetjeve tjera para Gjykatës.

Ai më pastaj ka thënë se ishte në rajonin e gjatë gjithë periudhës së luftës. Brigadës të UÇK-së i ishte bashkangjitur në vitin dhe ka mbetur pjesëtar i saj së bashku me **H.** dhe **Rr.** . Shtëpitë e tyre ishin afër shtëpisë së tij. Më 18 qershor 1999 gjatë gjithë ditës ishte në ku provonte të riparoj të paktën një dhomë të shtëpisë së tij që anëtarët e familjes të ktheheshin në shtëpi. Kjo i ka marrë rreth - ditë punë. Atij i kishin ndihmuar axha i tij H. G. dhe komshinjtë. Shtëpia e tij është rreth km larg . Ai nuk e kishte kuptuar se lufta kishte përfunduar më por këtë e kishte kuptuar vetëm më vonë. Ai i kishte dëgjuar emrat e G. dhe V.B. por nuk i njihnte ata, madje edhe po ti shihte.

Gjykata nuk u ka besuar dëshmitarëve të alibisë dhe të Pandehurit **S.G.** dhe ka konsideruar se deklaratat e tyre nuk e prishin besueshmërinë e deklaratës së J.B. i cili kishte parë të Pandehurin **S.G.** në vendin e ngjarjes duke vepruar ashtu si përshkruhet më lartë. Trupit Gjykues nuk ka përjashtuar mundësinë se **S.G.** dhe **H.G.** , me apo pa fqinjët tjerë, kanë qenë duke punuar në shtëpinë e **S.** në mëngjes e madje ndoshta edhe në orët e hershme të pasdites. Megjithatë, Gjykata është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se **S.** ishte larguar nga më vonë për të shkuar në ku ai kishte vrarë G.B. me të pandehurit tjerë **Rr.** dhe **H.G.** . Ishte e qartë se dëshmitari J. po gënjente Gjykatën kur ka pretenduar se kishte qenë me **S.G.** deri vonë pasdite. Nuk është e besueshme që ata dy po bisedonin për një orë dhe se asnjëri nga ata nuk po përmendte gjënë më të rëndësishme të popullatës shqiptare të Kosovës për vite, përkatësisht tërheqjen e forcave Jugosllave dhe Serbe nga rajoni i . Pasi që ai po largohej për në që është km larg , deklarata e tij dhënë Prokurorit ka kuptim në mënyrë të përkryer se ai kishte për tu larguar nga rreth orës - pas dite. Gjykata është e bindur se ai ka ndryshuar deklaratën e tij për t'i dhënë **S.G.** , që ishte anëtar i familjes, një alibi të rreme. E njëjta vlen për dëshmitarin H.G. . Gjykata beson se me deklaratën e tij ai po përpiqej të mbronte të Pandehurin **S.G.** i cili ishte si një djalë për të, që është motiv i fuqishëm për të deklaruar rrejshëm në favor të **S.G.** . Ai qartë ka thënë se kishte mësuar për çlirimin e më dhe se kjo ishte arsyeja pse njerëzit, duke përfshirë **S.G.** , në fakt po shkonin të shtëpitë e tyre për t'i riparuar ato. Prapë, nuk është e besueshme se ata nuk ishin në dijeni se edhe që është qyteti më i madh i afërt nuk ishte çliruar.

#### 4.3.2. I Pandehuri **Rr.G.**

Gjykata ka refuzuar alibinë që i Pandehuri **Rr.G.** ka paraqitur para Gjykatës lidhur me pasditen e .



Dëshmitari F.G. -fquinj i **Rr.G.** dhe banor i që nga lindja - i kishte deklaruar Gjykatës se ai jetonte në një distancë prej m larg shtëpisë së **Rr.G.** . Më ai kishte ndenjur në shtëpi. Ai kishte mësuar se kishte përfunduar lufta një ditë më pas kur disa njerëz i kishin thënë ashtu, më . Më ai dilte kohë pas kohe në kopshtin e tij për të pushuar nën hije. Ai e kishte parë **Rr.G.** që kishte të veshur uniformën e tij kamuflazhe duke punuar në kopshtin e tij sa herë që kishte dalë jashtë. Ai nuk fliste me të. Ai ka theksuar se gjatë luftës sigurisht që e kishte parë **Rr.** për çdo ditë. Ai, Dëshmitari, ishte ushtar i UÇK-së në brigadën e njëjta Nr. së bashku me **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** .

Dëshmitari A.G. - mik i mirë dhe fqinjë i **Rr.G.** dhe banues në që nga lindja - i ka deklaruar Gjykatës se shërbente në të njëjtën brigadë si të pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** gjatë luftës. Ai kishte mësuar vetëm një ditë pasi që ka përfunduar lufta - më - lidhur me atë se çka kishte ndodhur kur i kishte parë refugjatët duke kaluar nga fshati rrugës së tyre nga për në . Shtëpia e tij është rreth m larg shtëpisë së **Rr.G.** dhe distanca nga është rreth - . Distanca nga shtëpia e tij deri në qendrën mjekësore dhe në duhet të jetë . Ai e kishte matur këtë saktësisht pasi që ishte taksist që herë pas here punonte për pak para shtesë. Më kishte ndenjur terë ditën me **Rr.** . Ai kishte shkuar aty sepse shtëpitë e tyre ishin afër njëra tjetrës; ai kishte dëgjuar se një fëmijë ishte i sëmurë. Bashkëshortja e **Rr.** e kishte marrë këtë fëmijë të sëmurë dhe kishte shkuar vetëm nga për në . Kur ishte kthyer bashkëshortja nga veçse ishte errësuar.; ajo kishte treguar se kishte parë forca në por që nuk e dinte se trupat e kujt ishin. Dëshmitari A. më tej ka deklaruar se ai dëshironte të mbështeste **Rr.** që ishte mik i tij. Mes tjerash ata ishin duke ndenjur ulur bashkë dhe duke riparuar derën e shtëpisë së tij, te porta. Dhëndri i rij, B.B. gjithashtu ishte aty. Ai gjithashtu kishte parë F.G. , por nuk mund të thoshte se sa shpesh ka ndodhë kjo gjë. Ai gjithashtu ishte kthyer - herë te shtëpia e tij. Sa herë që është kthyer e kishte parë F. . Ai nuk kishte parë as S. e as H. atë ditë, të cilët jetojnë në një pjesë më të ulët të , më afër , dhe rreth - km larg shtëpisë së tij.

Dëshmitari B.B. – dhëndër i të Pandehurit **Rr.G.** - i ka deklaruar Gjykatës se më ka qenë me **Rr.G.** , motrën e tij dhe fëmijët e saj në . Motra e tij kishte guxuar të ecte nga deri në sepse fëmija i saj ishte i sëmurë. Ai dhe **Rr.** ishin në shtëpi dhe kishin bërë ca riparime sepse shtëpia ishte e pabanueshme. Atij nuk i kujtohet se çfarë kishin bërë ata. Motra e tij ishte larguar në mes të ditës dhe është kthyer vetëm pasdite. Më pastaj ajo kishte treguar se kishte parë forca të mëdha në , por se nuk dinte saktësisht se çka kishte parë. Dëshmitari kishte besuar se një sulm i forcave serbe është i pritshëm. Ai gjithashtu i kishte treguar Prokurorit në Deklaratën e tij të se A. kishte ardhur kohë pas kohe deri në mbrëmje për të ndihmuar (përgjigja në pyetjen nr. ). Ata të gjithë kishin kuptuar se ishte çliruar vetëm një ditë më pas, më , nga njerëz kalimtarë.

Dëshmitarja Sh.B.G. – bashkëshortja e të Pandehurit **Rr.** dhe motër e Dëshmitarës B. – i kishte deklaruar Prokurorit më se ajo kishte ecur në ditën e çlirimit të me bijën e saj të sëmurë dhe e kishte lënë të birin e saj tre vjeçar me bashkëshortin e saj **Rr.** , në shtëpi. Kur është kthyer në shtëpi pas perëndimit të diellit ajo kishte takuar bashkëshortin e saj, vëllain e saj B. , A. G. dhe të birin në shtëpi. Ajo u kishte thënë atyre se kishte parë shumë forca serbe dhe se ajo kishte menduar se ata kishin ardhur për të luftuar

kundër tyre. Në atë moment ajo kishte frikë. Bashkëshorti i saj dhe të tjerët nuk ishin përgjigjur fare. Dëshmitarja kishte menduar se ata e kishin parë se ajo kishte qenë e frikësuar dhe nuk dëshironin ta brengosin më shumë.

Dëshmitari M.G. i kishte deklaruar Prokurorit më se ai ishte fqinj i **Rr.G.** në . Shtëpitë e tyre ndaheshin vetëm nga një përroskë e vogël. As shtëpia e tij e as shtëpia e **Rr.** nuk ishin shkatërruar gjatë luftës. Ai e dinte se **Rr.** kishte fëmijë, por ai nuk e kishte ditur se sa fëmijë kishte dhe se bashkëshortja e **Rr.** ishte shtatzëne në atë kohë. Në ditën kur ishte çliruar ai ishte në shtëpinë e tij. Ai e kishte parë **Rr.** që nga aty; tashmë ishte mbrëmje dhe errët.

I Pandehuri **Rr.G.** nuk i ka dhënë deklaratë Gjykatës por i referohej deklaratës së tij të dhënë në procedurën paraprake që ia kishte dhënë Prokurorit më . Atëherë ai ka thënë se shtëpia e tij ishte djegur gjatë luftës dhe se në atë periudhë ai po jetonte në një vend në lagjen e B. , një lagje e , ku ai jetonte në një shtëpi të braktisur. Kjo shtëpi është rreth - km larg . Ai me vete kishte dy pushkë dhe posedonte kartelë autorizimi për të dyja.

Gjykata i ka gjetur dëshmitarët që po ofronin alibi për të Pandehurin **Rr.G.** në orët e vona të pasdites të si jo të besueshëm në këtë aspekt. Gjykata kishte dyshime nëse A.G. ishte i pranishëm në shtëpinë e **Rr.** tërë ditën, që të cilën B. nuk mund ta konfirmonte. Gjykata nuk besoi se njerëzit në e epërme kishin kuptuar se forcat jugosllave dhe serbe ishin tërhequr nga . Disa dëshmitarë kishin raportuar për njerëz që ishin duke lëvizur në të gjitha drejtimet në rrugë. Nuk është e besueshme që lajmi nuk ka arritur në , gjithashtu nëse kemi parasysh se Marrëveshja e Kumanovës veçse ishte nënshkruar më dhe tërheqja e pjeshme e trupave jugosllave dhe serbe nga rajonet tjera të Kosovës veçse kishte filluar. Edhe nëse fshati është i ndarë në dy pjesë, e epërme dhe e poshtme, ato nuk janë aq larg sa që një lajm kaq i rëndësishëm do të vonohej. Në këtë aspekt është interesante se Dëshmitari A.G. kishte llogaritur se distanca ndërmjet shtëpisë së **Rr.** dhe është - km, ndërsa vetë **Rr.** në intervistën e tij të procedurës paraprake kishte deklaruar se në fakt është - km larg.

Të gjithë dëshmitarët kishin motive të forta që ta shfajësojnë të pandehurin, pasi që ishin të afërm apo disa nga ata ushtarë të UÇK-së dhe fqinjë. Trupi Gjykues gjithashtu nuk i ka besuar rrëfimit se bashkëshortja e **Rr.** më ishte në dhe se nuk ka vënë re të shtënat e gëzimit. Gjykata e merr si më të mundshme se ajo ka qenë ndonjë ditë më herët në , atëherë kur trupat Jugosllave dhe Serbe akoma ishin aty dhe frika e saj duket të jetë e arsyeshme. Por edhe nëse ka qenë në atë ditë dhe nuk kishte vërejtur tërë gëzimin dhe kënaqësinë e të gjithë njerëzve rreth saj, atëherë nuk ka qenë pasdite vonë në dhe nuk ka mundur të konfirmoj se ku kishte qenë bashkëshorti i saj.

#### 4.3.3. I Pandehuri H.G.

**H.G.** nuk i ka dhënë deklaratë Gjykatës dhe i referohet deklaratës së tij të dhënë Prokurorit më . Ai më pastaj kishte thënë se nuk kishte qenë në më .

Si shpjegohet më lartë, Gjykata i beson dëshmitarit J.B. . I referohet tërë argumentimit të dhënë më lartë.

### 5. Vlerësimi përfundimtar:

Në një vlerësim të përgjithshëm duhet të thuhet se shqyrtimi gjyqësor është mbajtur në një situatë unike në të cilën vetëm pak dëshmitarë ishin paraqitur dhe e kishin thënë të vërtetën në Gjykatë. Edhe pse të dy vrasjet kishin ndodhur gjatë ditës dhe në mes të ku shumë persona ose është dashur të kenë parë të pandehurit ose viktimat apo të paktën do të kishin mundur të japin prova tjera, ka mbetur rast i pazgjidhur, asnjëherë nuk është hetuar nga policia vendore dhe dukej se kishte mirëkuptim të ndërsjellë se bashkëpunëtorët kanë marrë atë që e meritojnë apo të paktën, ky ishte një rast në të cilin askush nuk dëshironte të përfshihej. Ashtu si ka thënë vetë dëshmitari J.

, B. ishin njerëz me të cilët askush nuk dëshironte të kishte punë dhe përves vetë familjes B. , askush nuk ka treguar interesim për të sjellë vrasësit e G.B. para drejtësisë.

Ishte e qartë se dëshmitarit J.B. t nuk i pëlqente i Pandehuri **Rr.G.** për të cilin pretendon se ishte i përfshirë në pritë dhe në vrasjen e vëllait të tij Xh. dhe nipit B. në vitin dhe nuk e fshehte këtë ndjenjë para Gjykatës. Qysh në fillim të deklaratës së tij të datës iu kishte drejtuar të Pandehurve **G.** dhe iu kishte bërë pyetjen (retorike) nëse ata e dinin se sa nëna do të qanin për bijtë e tyre (procesverbali i datës , faqe ). Pastaj e kishte lajmëruar një incident me rastin e ndarjes së një traktori ku **Rr.** e kishte kërcënuar duke i thënë se ai duhet ta kujtoj çka i kishte ndodhur vëllait të tij në vitin ; ky ishte momenti kur ishin vrarë anëtarët e familjes së tij.

Gjykata beson se nëse J. kishte fabrikuar tërë rrëfimin kundër të Pandehurve **G.** ai nuk do t'i kishte shprehur këto ndjenja dehe do t'i kishte fshehur ato me qëllim që të mos e rrezikoj rrëfimin e tij të sajuar. Dëshmitari është person i arsimuar dhe padyshim se ishte në gjendje t'i kuptonte këto pasoja. Gjithashtu vlen të përmendet se dëshmitari nuk kishte shtuar ndonjë element tjetër fajësues. Po të donte të fajësonte p.sh. pikërisht **Rr.G.** , ai do të mund t'i thoshte se ishte ai i cili kishte hapur zjarr në vëllezërit B. në rrugë në rastin e të shtënave të para. Ai gjithashtu ka mundur të sajonte se e kishte parë **Rr.G.** apo të Pandehurit tjerë në atë pritën në vitin 2000, por nuk e kishte bërë këtë. Kjo e vërteton besueshmërinë e tij.

Vetë dëshmitari ka ofruar një shpjegim të besueshëm se pse nuk ishte paraqitur vullnetarisht me vështrimet e vitit para vitit . Ai ka thënë se kishte frikë sikur çdo njëri tjetër që ta thoshte të vërtetën dhe askush nuk do të dëshmonte në favor të familjes së të vdekurve të cilët i tërë qyteti i kosnideronte bashkëpunëtorë. Kjo ishte gjithashtu arsyeja e kuptueshme se pse ai nuk u kishte treguar anëtarëve të familjes për këtë rast.

Gjykata gjithashtu ka vlerësuar mundësinë që dëshmitari të ketë sajuar rrëfimin sepse jeta e tij do të kanosej duke dëshmitar kundër ish pjesëtarëve të UÇK-së dhe sepse ai dëshironte të futej dhe më vonë të mbetej në programin për mbrojtjen e dëshmitarëve. Megjithatë, Gjykata përjashton këtë mundësi sa i përket përshtypjes së përgjithshme që dëshmitari ka lënë para Gjykatës.

Sa u përket motiveve të të Pandehurve **G.** për ta vrarë G.B. , Gjykata është bindur se ata kishin vendosur të vepronin si një komision ekzekutiv për bashkëpunëtorët e pretenduar dhe

ndjeheshin të sigurt për ta bërë këtë në fund të luftës, kur Serbët po iknin dhe më nuk mund t'i mbronin bashkëpunëtorët. Kështu, me sa duket ata nuk kishin nevojë për urdhër nga zyrtar i rangut më të lartë i UÇK-së. Ishte e qartë se, siç ka theksuar Gjykata në shumë raste, askush që ka vrarë bashkëpunëtorët në atë kohë nuk kishte pse të frikohej për ndonjë pasojë, madje as nga vet familjet e viktimave. Dëshmitarja dhe pala e dëmtuar K.Xh.B. , e veja e të ndjerit V. , nuk ishte ajo që ishte paraqitur vullnetarisht, edhe pse e dinte, si ka deklaruar në Gjykatë, qysh atë ditë se të Pandehurit **G.** ishin të dyshuar se ishin kryerësit e veprës.

6. I Pandehuri **Dr. B.Sh.** (pika 3 e Aktakuzës)

I Pandehuri **Dr. Sh.** akuzohet në Aktakuzën e ndryshuar për veprën penale Ofrimi i Ndhimës pas kryerjes së veprës penale (Neni 305 KPK). Prokurori pretendon se ai i kishte dhënë deklaratë të rreme më dhe, duke vepruar kështu, duke u dhënë ndihmë të Pandehurve **G.** për të evituar zbulimin e tyre si kryerës.

Gjykata vërtetë është bindur se i Pandehuri **Dr. Sh.** më i kishte dhënë Prokurorit një deklaratë të pasaktë dhe nuk kishte treguar të vërtetën.

**Dr. B.Sh.** nuk i ka dhënë deklaratë Gjykatës, por herë pas herë ka dhënë komente. Ai iu është referuar deklaratave të tij të procedurës paraprake që i ka dhënë më në rolin e dëshmitarit dhe më në rolin e të Pandehurit. Ai ka refuzuar tu përgjigjet pyetjeve të Gjykatës.

Në deklaratën e tij të parë të procedurës paraprake ai kryesisht ka thënë se më pasdite ka qenë në ndërrim në qendrën mjekësore në . Në detyrë gjithashtu ishin Dr B.M. , F.O. dhe të tjerë. Duke filluar nga data deri më ishte një ekip prej njerëzish të cilët rrinin në qendrën mjekësore gjatë tërë kohës. Ai kishte mësuar se vëllezërit B. , të cilët i njihte për nga pamja, ishin vrarë më . Ai nuk kishte qenë dëshmitar i asgjëje por kishte dëgjuar versione të ndryshme lidhur me atë se çka u kishte ndodhur viktimave. Disa njerëz kishin thënë se në viktima ishte shtënë jashtë qendrës mjekësore, dhe njëri nga trupat kishte mbetur aty. Të tjerët kishin thënë se një ishte sjellë brenda në qendrën mjekësore. Ai – Dëshmitari – nuk kishte ditur se në çfarë gjendje kishte qenë ai dhe nëse në të ishte shtënë brenda në qendrën mjekësore. Ai ka theksuar se nuk i kishte parë vëllezërit B. as të vdekur e as të gjallë dhe trupat i kishte parë vetëm një ditë më vonë. Ai ka konfirmuar se G. ishte sjellë në qendrën në orët e vona të pas ditës të datës . I pyetur nëse e kishte njohur dëshmitarin J.B. atë ditë, ka deklaruar se ai ishte nga dhe anëtar i Kuvendit Komunal. Ka mohuar se kishte pasur kontakt më të afërt me të.

Në deklaratën e tij të dytë të procedurës paraprake dhënë Prokurorit, kur tashmë ishte në rolin e të dyshuarit ka theksuar shkallën e lartë të edukimit të tij dhe ka përsëritur se çka kishte thënë më ; ka shtuar se tërë kohën kishte qenë në repartin e gjinekologjisë të qendrës mjekësore. Ai nuk i kishte njohur **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** para se të intervistohesh nga Prokurori. Ai asnjëherë nuk kishte dëgjuar se kush i kishte vrarë viktimat. Ai kurrë nuk kishte folur me J.B. n lidhur me këtë rast dhe kurrë nuk është shoqëruar me të.

Gjykata nuk i ka besuar të Pandehurit **Dr. Sh.** se ai nuk kishte qenë në dhomën ku ishte kryer vepra penale dhe i beson dëshmitarit J.B. i cili e kishte parë të Pandehurin në dhomën e

kur të Pandehurit **G.** kishin vrarë G.B. . Për këtë, **Dr. Sh.** i kishte dhënë Prokurorit një deklaratë të pasaktë. Nuk ka mundur të vërtetohej deri në çfarë mase ka mundur i pandehuri të ofronte informata për identitetin e kryerësve të veprës, p.sh. në përshkrimin e pamjes së tyre fizike, pasi që kishte qenë, siç ka deklaruar në mënyrë të besueshme dëshmitari J.B. , në gjendje frike dhe shoku.

Kur i Pandehuri **Dr Sh.** ka dhënë deklaratën e tij më , hetimet ndaj **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** tashmë kishin filluar dhe të gjithë ishin futur nën masën e paraburgimit (shiko A I.). Deri më ishin mbledhur deklaratat e dëshmitarit J.B. (duke përjashtuar deklaratën e datës ), N.B. , K.Xh.B. dhe H.G. ; dëshmitarët B.Z. ,Q.A. , R.B. , A. , L. , Z.D. dhe Z.T. janë intervistuar të njëjtën ditë sikur **Dr Sh.** ose pak më vonë.

Gjykata nuk ka ardhur në konkludim se sjellja e **Dr. Sh.** në rrethanat e dhëna bie nën sferën e ndonjë veprë penale që duhet ndjekur, sidomos për shkak se ai nuk kishte ndihmuar në shmangien e zbulimit të **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** . Vepra penale e vrasjes së G.B. si e tillë dhe kontributi i tyre në të janë zbuluar në kuptim të ligjit kur J.B. i kishtë dhënë Prokurorit deklaratën e tij më (shih detajet në vijim, D IV.).

## D. Arsyetimi Ligjor

### I. Neni 142 LP RSFJ sa i përket vrasjes së G.B. (pika1 e Aktakuzës)

1. Të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** kanë kryer veprën penale Krime lufte kundër popullatës civile sipas Nenet 142 LP RSFJ i cili ishte ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale më 18 qershor 1999 sipas Nenet 3.1 të KP.

Neni 142 LPRSFJ përcakton:

*“Kushdo që duke shkelur rregullat e ligjit ndërkombëtar në fuqi në kohën e luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit, urdhëron që popullata civile t’u nënshtrohet vrasjeve [...], apo që kryen njërin nga veprimet e lartcekura, do të dënohet me së pakut pesë vjet burgim apo me dënim me vdekje”.*

Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II (GC II) si ligj relevant ndërkombëtar të cilit i referohet<sup>1</sup> Neni 142 LP RSFJ thotë:

<sup>1</sup>Vendimi i Gjykatës Supreme i datës në lëndën *Latif Gashi dhe të tjerët.*, f6 Konventat e Gjenevës të vitit 1949 ishin ratifikuar nga Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë në vitin 1950 dhe Konventa e Katërt e Gjenevës e vitit 1949 lidhur me Mbrojtjen e Personave Civil në Kohë Luftë ka hyrë në fuqi më 21 Tetor 1950. Protokolet e Konventave të Gjenevës janë ratifikuar në vitin 1979 dhe Protokollit Shtesë II i Konventave të Gjenevës ka hyrë në fuqi më 7 Dhjetor 1978. Sidoqoftë Neni 3 I Konventave të Gjenevës është pranuar gjerësisht se është bërë ligj zakonor ndërkombëtar dhe si i tillë është detyrues edhe për vendet jo-nënshkruese.

*“Në rast të konfliktit të armatosur të karakterit jo ndërkombëtar që ndodhë në territorin e njëres nga Palët e Larta Kontraktuese, çdo Palë në konflikt do të jetë e detyruar të aplikojë , së pakut, këto dispozita:*

(1) *Personat që nuk marrin pjesë aktive në armiqësitë, përfshirë pjesëtarët e forcave të armatosura të cilët kanë braktisur armët dhe ata që janë vënë ‘ jashtë luftës (hors de combat)’ nga sëmundja, plagët, paraburgimi, apo ndonjë shkak tjetër, religjion apo besim, gjini, lindje apo pasuri, apo ndonjë kriter i ngjashëm.*

*Për ta arritur këtë qëllim, veprimet vijuese janë dhe do të mbeten të ndaluara në çdo kohë dhe vend kudo qoftë për sa u përket personave të sipërpërmendur::*

(a) *dhuna ndaj jetës dhe personit, në veçanti vrasjet e çdo lloji, gjymtimi, trajtimi çnjerëzor dhe torturimi;*  
[...].

Të gjitha elementet e dispozitave të lartcekura janë plotësuar.

2. Ekzistenca e një konflikti të armatosur ndërmjet Forcave Jugosllave dhe Serbe dhe të UÇK-së në kuadër të luftës së Kosovës është vërtetuar nga Gjykata Supreme e Kosovës në Vendimin lidhur me lëndën të datës . Ky konstatim është konfirmuar në Vendimin e Gjykatës Supreme të datës në lëndën L.G. dhe të Tjerët., f. - . Në këtë Vendimin e fundit gjithashtu konstatohet se struktura organizative e UÇK-së gjithashtu plotëson kërkesat nga Neni i Përbashkët 3 i Konventave të Gjenevës dhe Protokollit Shtesë II. Gjykata u referohet këtyre vendimeve dhe vetëm thekson se konflikti i armatosur ekziston kurdo që ka veprim të forcës së armatosur ndërmjet shteteve apo dhunë të zgjatur të armatosur ndërmjet autoriteteve qeveritare dhe grupeve të organizuara të armatosura apo ndërmjet grupeve të tilla brenda një shteti. Ky ka qenë rasti ndërmjet forcave të ish Jugosllavisë dhe Serbisë dhe UÇK-së në anën tjetër. Në Kosovë ka pasur konflikt të armatosur që ka vazhduar.

Është jo relevante që më pjesë të forcave të ish Jugosllavisë dhe Serbisë tashmë ishin tërhequr nga disa pjesë të Kosovës, pasi më ishte nënshkruar e ashtuquajtura Marrveshja e Kumanovës. Jurisprudenca ndërkombëtare është vendosur, Neni i përbashkët 3 KGJ II e ka statusin e ligjit zakonor ndërkombëtar dhe zbatimi i tij nuk është i kufizuar në afat të përkohshëm apo kur luftimi është faktikisht duke ndodhur. Mbrojtja dhe fushëveprimi shtrihet në të gjitha zonat e territorit nën kontroll të një pale në konflikt (TPNJ, T. , Vendimi lidhur me Propozimin e Mbrojtjes për Ankesë Interlokutore mbi Kompetencat i datës 2 tetor 1995, para. 69 deri 70 dhe 102). Brenda një shteti, nuk është e nevojshme të vërtetohet se një konflikt i armatosur ka ekzistuar në secilën komunë, mjafton se ai ka ekzistuar brenda një rajoni më të gjerë ku kanë ekzistuar komunat, me fjalë tjera tërësia e entitetit territorial.

Sipas Marrëveshjes së Kumanovës tërheqja e forcave Jugosllave duhej të përfundonte brenda 11 ditësh pas hyrjes së saj në fuqi që ishte data . Sipas të gjithë dëshmitarëve të dëgjuar, forcat Jugosllave dhe Serbe posa ishin larguar nga dhe tërheqja nga i tërë territori i Kosovës nuk kishte përfunduar akoma. Në këtë situatë kur të dy palët në konflikt akoma ballafaqoheshin njëra me tjetrën brenda një territori, konflikti nuk ka përfunduar dhe paqja nuk është siguruar. Prandaj është jo relevante se më forcat Jugosllave dhe Serbe ishin tërhequr nga Skenderaj ku kishte ndodhur vepra penale.

Gjykata është gjithashtu e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se konflikti ka luajtur një rol substancial në mundësinë, vendimin mënyrën dhe qëllimin e kryerësve për veprën që janë kërkesa tjera për kryerjen e krimit të luftës (K. (IT-96-23 & IT-96-23/1-A) Aktgjykimi mbi ankesën i datës 12 qershor 2002, para. 58). Nuk ka dyshim se më posa kishte nën kontrollin e një pale në konflikt, përkatësisht të UÇK-së, ndërsa pala tjetër, forcat e parregullta dhe të rregullta Jugosllave dhe Serbe posa ishin tërhequr. Gjyakta e ka gjetur të vërtetuar faktin se të Pandehurit kishin vepruar për shkak të se ishin pjesëtarë të UÇK-së, dhe se viktimat që ishin civilë në atë kohë ishin zgjedhur për vrasje për shkak të bashkëpunimit të supozuar me Serbët në lidhje me konfliktin e armatosur që kishte ndodhur në atë kohë. Natyra e saktë e rolit dhe gradës që kanë pasur të Pandehurit nuk është e qartë, dhe as që ka nevojë të jetë. Një lidhje e qartë ndërmjet të pandehurve, viktimave, sjelljes, trajtimit dhe kontrollit territorial është vërtetuar.

3. Elementet objektive nga Neni 142 LPRSFJ lidhur me dispozitat përkatëse të konventës së Gjenevës janë plotësuar sepse G.B. është vrarë. Vrasja me dashje konsiderohet një shkelje e rëndë e ligjit dhe është baras me Vrasje (shih M. et al, IT-96-21-T, Aktgjykimi i datës para. 422 deri 423; dhe Nenet 146 dhe 146 të Konventës së katërt të Gjenevës). Neni 142 LPRSFJ nuk bënë dallime ndërmjet llojeve specifike të vrasjeve dhe vrasjes dhe vrasjes së rëndë.

4. Elementet subjektive të veprës penale janë plotësuar gjithashtu. S. , Rr. dhe H.G. e kanë ditur se duke shkrepur disa plumba në G.B. ai do ta humbte jetën dhe ata kanë dashur që kjo të ndodhte. Qëllimi i tyre i përbashkët për ta bërë këtë ishte që ta dënonin G. për bashkëpunimin e pretenduar të tij me Serbët gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë. Ata e kanë ditur se nuk kishin asnjë të drejtë për të dënuar dhe në veçanti për ta vrarë viktimën.

5. S. , Rr. dhe H.G. kanë vepruar në bashkëkryerje sipas Nenit 22 të LPRSFJ i cili përcakton:

*Nëse disa persona bashkërisht kryejnë një veprim kriminal duke marrë pjesë në aktin e kryerjes apo në ndonjë mënyrë tjetër, secili nga ta do të dënohet siç parashihet për atë veprim.*

Bashkëkryerja nga Neni 22 LPRSFJ kërkon që akti i kryerjes duke marrë pjesë në aktin e kryerjes, por kjo mund të bëhet edhe në “ndonjë mënyrë tjetër”. Ligji prandaj nuk kërkon kontribut fizik. Nuk është e obligueshme që të gjithë kryerësit të ngrehin këmbëzën e armës, apo vetëm personi që faktikisht ka shtënë mund të konsiderohet si kryerës ndërsa të tjerët mund të jenë vetëm ndihmës. Në këtë konstelacion vetëm ekzistimi i një argumenti apo i një plani të përbashkët ndërmjet dy apo më shumë personave që, nëse zbatohet, do të rezultojë në kryerjen e veprës penale, është esencial.

Gjykata është e bindur përtej dyshimit të arsyeshëm se të tre të Pandehurit S. , Rr. dhe H.G. kanë vepruar sipas një plani të përbashkët për të cilin ishin pajtuar më së voni kur kishin hyrë në qendrën mjekësore. Ata kanë i kanë shkuar pas viktimës në këtë objekt dhe kanë hyrë në dhomë derisa të gjithë të tjerë po qëndronin në korridor. Ata kanë parë se G.B ishte i shtirë në shtrat pa pasur mundësi të mbrohej apo të ikte, pra duke qenë i pa aftë, dhe e kishin ekzekutuar. Rrjedha e ngjarjeve vërteton se asnjëri nga të Pandehurit nuk ka dashur që vetë ta ndihmonte apo mbështeste personin i cili faktikisht kishte shtënë por të gjithë kanë pasur për qëllim të kryejnë veprën penale si një veprim të përbashkët.

6. Nuk ka rrethana të dukshme apo të vërtetuara që do të mund ta përjashtonin përgjegjësinë penale të të Pandehurve **S.** , **Rr.** apo **H.G.** sipas Neneve 16 dhe 17 LPRSFJ (gabim fakti apo ligji).

7. Pasi është vërtetuar vepra penale të cilën e kishin kryer të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** , Gjykata është dashur të vendos nëse kishte ligj më të favorshëm për ta zbatuar.

Të Pandehurit kanë kryer veprat penale në kur ligji i aplikueshëm ishte Ligji Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ( RSFJ). LPRSFJ ishte miratuar nga Kuvendi i RSFJ më 28 shtator 1976 dhe kishte hyrë në fuqi më 1 korrik 1977. Ky Ligj ka mbetur në fuqi deri më 06 Prill 2004 kur kishte hyrë në fuqi Rregullorja e UNMIK-ut 2003/25 me emrin Kodi i Përkohshëm Penal i Kosovës. Ligji i Aplikueshëm në Kosovë rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/24 (e ndryshuar me Rregulloren e UNMIK-it 2000/53) përcakton se çdo ligj në fuqi para datës 22 Mars 1989 vazhdon të zbatohet pas datës edhe pse dënimi me vdekje ishte shfuqizuar dhe zëvendësuar me kohën maksimale të dënimit me burg prej 40 vjet (Nenet 1.1(b) dhe 1.5, dhe 2 deri 4; dhe Nenet 1.6 dhe 3 e rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/53). TKodi i Përkohshëm Penal kryesisht ishte ndryshuar më 06 nëntor 2008 duke ndryshuar emrin në Kodi Penal i Kosovës. Kodi i ri Penal i Republikës së Kosovës. (Ligji Nr. 4/L-082) ka hyrë në fuqi më 01 Janar 2013 që është para vendimit të formës së prerë në këtë lëndë.

Neni 3 i Kodit të ri Penal (2013) thotë se në këto raste duhet të zbatohet ligji më i favorshëm.

Trupi Gjykues nuk ka gjetur se dispozitat e reja nga Nene 152 lidhur me Nenin 31 të KP janë më të favorshme për të Pandehurit. Neni 152 KP gjithashtu I referohet Nenit 3 te konventës së Gjenevës të datës 12 Gusht 1949. I vetmi dallim relevant është se kjo dispozitë parasheh një dënim me burg jo më pak se pesë (5) vjet nga dënimi me burg të përjetshëm. Dënimi me burg të përjetshëm sipas ligjit nuk kufizohet në shumë të caktuar vjetësh dhe teorikisht mund të shqiptohet për më shumë se 40 vjet. Prandaj, Neni 142 LPRSFJ është ligji më i favorshëm dhe ligji që zbatohet në këtë rast.

#### II. Neni 142 LPRSFJ lidhur me vrasjen e V.B. (pika 1 e aktakuzës)

Gjykata nuk i ka gjetur **S.** , **Rr.** apo **H.G.** fajtor dhe penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Krime Luftë kundër popullatës civile (Neni 142 LPRSFJ ) në lëndën e V.B. siç pretendon Aktakuza në Pikën 1.

Sipas argumentimit të mësipërm, nuk ka mundur të vërtetohet nëse V.B. ishte qëlluar një e shtënë e qëllimshme dhe nëse po, cili nëse ndonjëri, nga të Pandehurit **G.** vërtetë kishte shtënë në V.B. , as se të tre të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** në këtë moment kishin vepruar sipas një plani për ta vrarë atë. Gjykata nuk ka mundur të vërtetojë se të Pandehurit **G.** kishin shkuar në vendin e ngjarjes në qendër të qytetit në me qëllimin për t'i vrarë dhe as se të gjithë ata e kanë ditur se një apo më shumë prej tyre do të takoheshin dhe shtinin në **G.** dhe **V.B.** . Prandaj, Gjykata konstaton se **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** nuk kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen se i përket V.B. dhe duhet të lirohen nga kjo akuzë.

#### III. Neni 142 LPRSFJ sa u përket Palëve të Dëmtuara I. dhe M.V. (pika 2 e Aktakuzës)

Gjykata nuk i gjen të Pandehurit **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** fajtorë dhe penalisht përgjegjës për plagosjen e I. dhe M.V. më në dhe për kryerjen e veprës



penale Krime Luftë kundër popullatës civile (Neni 142 LPRSFJ ) siç përcaktohet në pikën 2 të Aktakuzës.

Elementet objektive të veprës penale nuk janë plotësuar. Duke iu referuar argumentimit të mësipërm, nuk është vërtetuar se të shtënat në G. dhe V.B. që kanë qenë ato që kanë qëlluar I. dhe M.V. , dhe madje edhe po të ishte kështu, çdo e shtënë në këtë moment nuk mund të lidhet në mënyrë mjaftë të qartë me ndonjë veprim të të Pandehurve G. .

Prandaj, Gjykata konstaton se **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** nuk kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen sa u përket I. dhe M.V. dhe duhet të lirohen nga kjo akuzë.

#### IV. Neni 305 KPK (pika 3 e Aktakuzës)

Gjykata ka konstatuar se me dhënien e deklaratës së pasaktë para Prokurorit më i Pandehuri **Dr Sh.** nuk ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet – Neni 305.1 dhe 2 KPK – për shkak të arsyeve ligjore; i është referuar argumentimit të Kryetarit të Trupit Gjykses në Aktvendimin mbi pranimin e aktakuzës dhe me këtë ka devijuar nga vlerësimi ligjor i Gjykatës së Apelit të Kosovës të dhënë në Aktvendimin e saj Nr. KA 490/2013 të datës 6 Maj 2013 lidhur me këtë rast.

Neni 305.1 dhe 2 KPK përcakton:

*“Kushdo që strehon kryerësin e veprës penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare ose e ndihmon atë në shmangien e zbulimit të veprës përmes fshehjes së mjeteve, provave a në çfarëdo mënyre tjetër, ose kushdo që strehon personin e dënuar apo ndërmerr veprime për pengimin e ekzekutimit të dënimit a urdhrin për trajtim të detyrueshëm dënohet me burgim deri në një vit.*

*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni ka të bëjë me një apo më shumë prej veprave penale në vijim, kryesi dënohet me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.”*

1. Gjykata e Apelit e Kosovës ka gjetur qenësore të përqendrohet në pyetjen kur një kryerës i veprës penale mund të konsiderohet si i ‘zbuluar’ në kuptim të Nenit 305 të KPK dhe argumenton në këtë rast si vijon:

*“Opsionet e mundshme janë vendimi i Prokurorit për iniciimin e hetimeve kundër një të dyshuari të paidentifikuar për një vepër penale (Neni 104 KPK) në bazë të dyshimit të arsyeshëm, ngritja e aktakuzës në bazë të dyshimit të bazuar mirë (Neni 240 et seq. KPK), apo siç sugjeron Prokurori Special, dënimit përfundimtar të të pandehurit.*

*Trupi Gjykses konstaton se një vepër penale mund të konsiderohet e zbuluar në kuptim të Nenit 305 (1) të KPK nga koha e ngritjes së aktakuzës. Standardi i dyshimit të bazuar mirë (Neni 19 (1.12) i KPK) kërkon më shumë se një gjasë substanciale që një vepër penale të jetë kryer nga kryerësi. Pretendimet faktike përcaktohen mjaftueshëm në atë fazë dhe me ngritjen e Aktakuzës Prokurori ka përcaktuar konkretisht veprimin kriminal dhe akuzat kundër një të dyshuari konkret (tani i akuzuar). Për fillimin e hetimeve, kryerësi vetëm duhet të identifikohet dhe personi në fjalë mund apo mund të mos ketë kryer veprën penale. Ky është një standard substancial më i ulët dhe gjatë hetimeve në vazhdim rrethanat faktike nuk janë aq rigorozë siç është rasti pas ngritjes së Aktakuzës dhe prandaj mund t’u nënshtrohet ndryshimeve fundamentale.*

*Konstatimi i Trupit Gjykes gjithashtu mbështetet nga një interpretim sistematik i KPK, mandatuar me qëllim të përcaktimit të një dallimi të qartë ligjor ndërmjet fushëveprimit të aplikimit të dispozitave penale të Nenit 305 dhe 307 të KPK. Neni 307 i KPK inkriminon deklaratën e rrejshme të dhënë nga dëshmitarët gjatë procedurës gjyqësore. Procedura gjyqësore fillon me ngritjen e aktakuzës. Kështu, nuk ka nevojë të zgjerohet fushëveprimi i aplikueshëm i Nenit 306 të KPK për të mbuluar edhe fazën e procedurës penale siç sygjeron Prokurori Special. Neni 306 i KPK, në anën tjetër, gjithashtu mbulon fazën e hetimeve por aplikohet në situatat e kualifikuara që kërkojnë më shumë se sa dhënia e deklaratës së rreme prokurorit apo hetuesit”.*

Trupi Gjykes nuk pajtohet me këtë interpretim të Nenit 305 KPK, as kur kemi të bëjmë me interpretimin e përgjithshëm të fjalëve të Nenit dhe qasjes sistematike, as zbatimin e dispozitës në rastin konkret të të Pandehurit **Dr. Sh.**

2. Është e qartë se jo çdo lloj i ndihmës dënohet, por (vetëm) rastet e cekura në Nenin 305 të KPK. Trupi Gjykes konstaton se rasti tipik i ‘strehimit’ është p.sh. ofrimi i strehimit për një plaçkitës që është duke ikur nga banka. Ai që i ofron strehim në këtë moment nuk ka nevojë të ketë vlerësim të qartë të natyrës së veprës penale të cilën as nuk e ka kryer as nuk duhej ta di identitetin e kryerësve. Njohuria e përgjithshme, jo shumë e saktë për një vepër penale të kryer do të mjaftonte.

Neni 305 KPK nuk cek se “dhënia e ndihmës” në çfarëdo mënyre të përgjithshme do të përbente vepër penale por “dhënia e ndihmës për të evituar zbulimin”. Prandaj, ‘zbulimi’ është element qenësor. Interpretimi i fjalëve të ligjit, sinonimi për fjalën ‘zbulojë’ është ‘nxjerr në shesh’ apo ‘detektojë’. Në ‘zbulim’, ekziston një moment inherent i nxjerrjes spontane në shesh së një fakti i cili ka qenë i panjohur më parë. Një veprim tipik do të ishte p.sh. t’i ofrosh plaçkitësit në ikje në shembullin e mësipërm një veturë për të ikur nga policia menjëherë pas veprës. Gjithashtu me këtë rast nuk do të ishte e domosdoshme që dhënësi i ndihmës të dijë saktësisht natyrën e veprës penale të kryer apo identitetin e kryerësve.

Në interpretimin e Trupit Gjykes, ‘zbulimi’ ka të bëjë më tepër me momentin spontan në një fazë shumë të hershme dhe ngushtë e lidhur me veprën penale, dhe jo me nivelet e ndryshme të dyshimit dhe as me vlerësimin nëse rrethanat faktike janë tashmë (mjaftë) të qëndrueshme apo jo. Nëse ky ishte rasti mund të supozohej se ligjvënësi kishte zgjedhur fjalët “dënim’ apo ‘ngritje të aktakuzës’ në vend të ‘zbulim’. Faktet në çdo fazë të procedurës penale mund tu nënshtrohen ndryshimeve fundamentale, p.sh. kur pas ngritjes së Aktakuzës në seancën e parë apo të dytë fillestare Mbrojtja ngritë kundërshtime apo të pandehurit ofrojnë alibi. Prandaj, nuk është e qartë pse ngritja e aktakuzës do të ishte pikë-kthesë ndërmjet një kryerësi ‘të zbuluar’ apo ‘të pazbuluar’.

Interpretimi i ligjit që barazon fjalën ‘zbuluar’ me ‘akuzuar’ apo madje edhe me ‘dënuar’ dhe në këtë mënyrë i referohet një faze më të vonë të hetimeve penale apo madje edhe fundit të shqyrtimit gjyqësor do të shkonte përtej fjalëve të vetë ligjit dhe do të cenonte parimin ligjor ‘nulla poena sine lege stricta’. Pranohet vetëm në raste shumë të rralla që fjalët qartazi bien ndesh me qëllimin e ligjvënësit që këtu nuk kemi të bëjmë me të, madje përkundrazi. Ligjvënësi tani së voni ka rishikuar kodin penal dhe ka miratuar një version të ri që ka hyrë në fuqi më 1.1.2013.

Neni i ri përkatës 388 KP përcakton në pjesët e tij përkatëse:

*“Kushdo që strehon kryerësin [...] apo i ndihmon atij apo asaj të evitojë zbulimin apo arrestimin ... do të dënohet.” [nënvizimet e vëna nga Gjykata].*

Nga këto fjalë rrjedh qartazi se vepra penale e ofrimit të ndihmës mund të kryhet në një fazë shumë të hershme madje edhe kur hetimi ende nuk ka filluar, përkatësisht për të evituar arrestimin e një personi. Nevojitet vetëm dyshimi i bazuar për arrestim dhe jo dyshimi i bazuar mirë apo madje edhe dënimi (Neni 164.1.1. KPK). Prandaj, mund të konkludohet se edhe ‘zbulimi’ i një kryerësi – që vihet në rregull para arrestimit në kuadër të pikave të Nenit 388 KP – nuk lidhet me momentin kur dyshimi është shndërruar në dyshim të bazuar mirë dhe në ngritje të aktakuzës. Është jo-relevante që fjala ‘arrestim’ nuk përmendet në kodin e vjetër. Fakti që ligjvënësi e ka ndryshuar Nenin 305 KPK në mënyrën e lartcekur tregon se Neni 305 KPK duhet të lexohet dhe interpretohet në mënyrë që përputhet me Nenin 388 KP në kodin e ri.

3. Interpretimi i ligjit nga Trupi Gjykses vërtetohet me krahasimin sistematik në kuadër të sistemeve juridike të Neneve 303 – 315 të Kodit të vjetër Penal, përkatësisht Neneve 384 – 408 të Kodit të ri Penal.

Kodi Penal përmend termat ‘zbulim’ dhe ‘kryerës’ jo vetëm në Nenin 305 KPK (388 KP), por edhe në Nenin 304 KPK (386 KP). Neni 304 KPK përcakton:

*(1) Kushdo që duke qenë në dijeni për identitetin e kryerësit të veprës penale ose për kryerjen e veprës së tillë penale, e cila dënohet me burgim afatgjatë, nuk lajmëron faktin e tillë edhe pse zbulimi i kryerësit të veprës penale varet nga ky lajmërim dënohet me burgim deri në tre vjet.*

*(2) Personi zyrtar apo personi përgjegjës i cili nuk e lajmëron veprën penale të cilën e ka zbuluar gjatë ushtrimit të detyrës së tij dënohet me dënimin nga paragrafi 1 i këtij nëse vepra e tillë është e dënueshme me së paku tre vjet burgim dhe ndiqet sipas detyrës zyrtare. [nënvizuar nga Gjykata]*

Ky Nen në përgjithësi nuk do të kishte kuptim nëse një ‘kryerës i zbuluar’ është vetëm një person ndaj të cilit është ngritur aktakuza apo i cili është dënuar. Termi ‘zbuluar’ qartazi ka të bëjë me momentin kur personi fiton njohuri për identitetin e kryerësit dhe është në dijeni (përkatësisht: ka zbuluar) se një vepër e mundshme penale është kryer. Kodi penalizon këtë mos raportim dhe se për shkak të faktit se identiteti i kryerësve mbetet i panjohur, nuk mund të fillojë hetimi adekuat. Gjithashtu nuk ka shenjë se ligjvënësi ka dashur ta përdor termin e zbulimit në mënyra të ndryshme në dy nenet e pasuese. Prandaj, një analizë sistematike vërteton mendimin juridik të Trupit Gjykses.

Gjykata vetëm vë në dukje se në Nenet tjera në Kodin Penal, si Neni 142 KPK, fjala ‘zbuluar’ gjithashtu përdoret në mënyrën si Trupi Gjykses e interpreton ligjin. Ligjo thotë:

*‘Neni 142*

*Fshehja ose moslajmërimi i terroristëve dhe grupeve terroriste*

*1. Kushdo që fsheh ekzistimin e një grupi terrorist ose të anëtarëve të tij, e pengon zbulimin ose kapjen e grupit terrorist ose të anëtarëve të tij, dënohet me burgim prej tre (3) deri në dhjetë (10) vjet.*

Zbulimi qartazi ka të bëjë me një fazë shumë të hershme dhe e vënë atë në renditje madje edhe para kapjes së kryerësit.

Një shembull tjetër është Neni 316.3 KP kur Gjykata mund të heq dorë nga dënimi nëse kryerësi raporton se e kishte kryer veprën penale para se të ishte zbuluar ose para se ai apo ajo kishte qenë në dijeni se ishte zbuluar. Nuk do të kishte kuptim të raportohej një vepër penale për të cilën kryerësi tashmë ishte akuzuar apo madje edhe dënuar. Prapë, nuk ka indikacion se ligjvënësi ka dashur ta përdorë termin e zbulimit në një mënyrë tjetër nga dispozitat tjera në Kod.

4. Interpretimi i ligjit nga Gjykata nuk çon në zbrazësi të pajustificuar në kuadër të ligjit dhe edhe po të ishte ashtu, nuk i përket Gjykatës ta plotësonte zbrazëtirën në ligj dhe të zgjerojë fushëveprimin e ndonjë Neni në kuadër të sistemit të Neneve 304 – 308 KPK në dëm të të Pandehurit.

Gjykata nuk injoron se secili sistem juridik ka interes vital dhe legjitim që të ketë autoritete hetuese funksionale që nuk pengohen nga dëshmitarë gënjeshtarë. Në kuadër të procedurave penale dëshmitari në rastet më së shpeshta është prova më e rëndësishme, siç është në këtë rast.

Megjithatë, Trupi Gjykues vë në dukje se ligjvënësi ka vendosur në Nenin 307 KPK se dhënia e deklaratës së rreme dënohet vetëm në kuadër të procedurës gjyqësore, jo në fazën e procedurës paraprake. Po të kishte dashur ligjvënësi ta dënojë dhënien e deklaratës së rreme para Prokurorit në fazën e procedurës paraprake, do ta kishte përmendur Prokurorin në Nenin 307 KPK, më së voni kur Kodi Penall ishte në rishikim dhe në fuqi ka hyrë Kodi i ri më 1.1.2013. Ligjvënësi nuk ka vepruar ashtu. Nuk i takon Trupit Gjykues që ta plotësojë një zbrazësi të mundshme në ligj. Gjithashtu nuk ka indicie se Neni 305 KPK do të shërbejë si dispozitë e përgjithshme për të gjitha rastet që nuk i mbulon Neni 307 KPK. Nëse është ashtu, ligjvënësi nuk do të kishte përdorur renditjen në Nenin 305 KPK, duke iu referuar rasteve të posaçme të dhënies së ndihmës.

Për këtë, Trupi Gjykues vëren se sipas Nenit 125 KPP dëshmitari paralajmërohet se mund të ndiqet (vetëm) sipas Nenit 390 (raportimi i rremë) apo 391 (deklarata e rreme nën betim). Paralajmërimi nuk përmban Nenin 388 KP (dhënia e ndihmës pas kryerjes së veprës penale).

Interesi i cekur juridik i një sistemi funksional juridik mbrohet në Nenin 306 KPK, por u referohet situatave të kualifikuara, si thekson Gjykata e Apelit në Aktvendimin e lartcekur. Raportimi i personit të gabuar dhe dhënia e provave të rreme, me të cilat hetimi drejtohet në një drejtim tjetër dhe/ose vonohet për një periudhë të caktuar, përbën vepër penale. Në këto rrethana, dëshmitari gënjeshtar luan rol shumë aktiv. Dëshmitari që mohon se ka qenë në vendin e ngjarjes, si ka vepruar i pandehuri **Dr. Sh.** , vepron në një mënyrë dukshëm më ndryshe.

Nga pikëpamja e autoriteteve hetuese dhe e sistemit juridik si të tillë, do të ishte e dëshirueshme që të sigurohet se gënjimi para Prokurorit në fazën e Procedurës Paraprake përbën vepër penale. Por prapë, nuk i takon gjykatës ta interpretojë ligjin apo të krijojë analogji në dëm të të Pandehurit apo t'i plotësojë zbrazëtirat ligjore.

5. Duke aplikuar këtë mendim juridik në rastin e të pandehurit **Dr. B.Sh.** , momenti i zbulimit të kryerësve ka ndodhur kur dëshmitari kryesor J.B. më ka dhënë deklaratë para Prokurorit. Kjo ka ndodhë pas rreth vitesh të heshtjes në një rast të pazgjidhur për herë të parë autoritetet që donin të vepronin vënë krimin si të tillë dhe emrat e kryerësve të pretenduar; kjo paraqet pikën kthesë në këtë rast dhe momentin e zbulimit. Siç e ka shtjelluar më lartë Gjykata, dënimi i të Pandehurve **G.** kryesisht bazohet në J.B. n i cili ka dhënë deklaratat në fazën e

procedurës paraprake në , dhe para se të ngritej Aktakuza në Dhjetor 2012. Situata e provave për rastin e prokurorisë nuk ka ndryshuar dukshëm dhe nuk ka nivel të ngritur të dyshimit në momentin kur është ngritur aktakuza. Asnjë nga dëshmitarët që janë dëgjuar pas të Pandehurit **Dr. Sh.** nuk i ka ndihmuar prokurorisë për të arritur nivel më të lartë të sigurisë kur kemi të bëjmë me faktet që fajësojnë të Pandehurit **G.** si kryerës.

Përveç kësaj, fakti se **Dr. Sh.** nuk ka thënë të vërtetën më , as nuk e ka vonuar apo dezorientuar hetimin në çfarëdo mënyre. Kjo ka bërë që në fund rasti i prokurorisë të jetë më vështirë për tu vërtetuar, por të Pandehurit kanë paraqitur alibi, dhe shumë dëshmitarë nga i është dashur të dëgjoen. Lirimi i pjesshëm i të Pandehurve **G.** kishte të bënte me ngjarjet që kishin ndodhur në rrugët e sa i përket vrasjes së V.B. ku i Pandehuri **Dr.Sh.** nuk kishte qenë i pranishëm.

Gjykata thekson prapë se ekziston një dispozitë ligjore që e pengon dëshmitari të mos gënjej. Në rastin në fjalë, Prokuroria ka mundur ta thërriste **Dr. B.Sh.** si dëshmitar para Gjykatës dhe ta ballafaqonte me deklaratën e J.B. t me qëllim që të marr një deklaratë. Ka mundur të ndodhte ose jo që i Pandehuri **Dr. Sh.** në rolin e dëshmitarit në vend se në rolin e të Pandehurit ka mundur ta thoshte të vërtetën, p.sh. nën betim para Gjykatës. Atëherë atij do t'i duhej të ballafaqohej me ndjekjen penale sipas Nenit 392.1 KP.

Për të gjitha arsyet e lartcekura, i Pandehuri **Dr. Sh.** është dashur të lirohet nga akuza kundër tij.

## E. CAKTIMI I DËNIMIT

Gjykata është dashur ta caktojë dënimin për të Pandehurit e dënuar **S.** , **Rr.** dhe **H.G.** .

Sipas Nenit 33 LPRSFJ qëllimi i dënimit në kuadër të qëllimit të përgjithshëm të sanksioneve penale (neni 5, para 2) është 1) parandalimi i kryerësit në kryerjen e veprimeve kriminale dhe rehabilitimi i tij; 2) ndikimi rehabilitues në të tjerët që të mos kryejnë veprime penale; 3) përforcimi i fides morale të shoqërisë vetë-qeverisëse dhe ndikimi në zhvillimin e përgjegjësisë shoqërore dhe disiplinës së qytetarëve. Sepse për të arritur qëllimet e dënimit gjykata duhet që në përputhje me Nenin 41 të LPRSFJ të caktoj dënimin për veprimin kriminal në kuadër të kufijve që i jep statuti për një veprim të tillë, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat që bien në magnitudën e dënimit (rrethanat lehtësuese dhe rënduese), dhe, në veçanti, shkallën e përgjegjësisë penale, motivet nga të cilat është kryer veprimi, shkallën e rrezikut apo lëndimit të objektit të mbrojtur, rrethanat në të cilat është kryer veprimi, sjellja e kryerësit në të kaluarën, gjendja e tij personale dhe sjellja e tij pas kryerjes së veprimit kriminal, si dhe rrethanat tjera lidhur me personalitetin e kryerësit. Qëllimi i cekur në para 3 të Nenit 33 LPRSFJ sipas të gjitha gjasave është zhdukur me dobësimin e RSFJ.

**S.** , **Rr.** dhe **H.G.** dënohen për një pikë të akuzës Krime Lufte kundër Popullatës Civile sipas Nenit 142 të LPRSFJ lidhur me Konventën e Gjenevës. LPRSFJ parasheh dënimin minimal prej pesë vjetësh burgim dhe dënimin maksimal – dënimi me vdekje për këtë vepër penale. Dënimi me

vdekje më vonë është shfuqizuar në Kosovë dhe është zëvendësuar me dënimin prej katër dhjetë vjet burgim.<sup>2</sup>

Në rastin e të Pandehurit **S.G.** Trupi Gjykses ka gjetur si rrethanë të dukshme lehtësuese kohën e gjatë që ka kaluar pas vitit . **S.G.** nuk ka pasur dënime paraprake dhe ka qenë qytetar i mirë para kryerjes së veprës penale dhe pas saj. Si rrethana rënduese Trupi Gjykses gjeti se G.B. ishte i plagosur dhe prandaj person i paaftë. Qendra mjekësore ka qenë strehë e sigurt që është shkelur.

Pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartcekura, Gjykata shqiptoi këtë dënim:

Për veprën Krime Luftë kundër Popullatës Civile në rastin e G.B. , në shkeljet të Nenit 142 LPRSFJ lidhur me Konventën e Gjenevës në kuadër të një periudhe të paraparë me ligj ndërmjet pesë (5) dhe katër dhjetë (40) vjet burgim, dënimin prej:

#### **Dymbëdhjetë (12) vjet burgim.**

Në rastin e të Pandehurit **Rr.G.** Trupi Gjykses ka gjetur si rrethanë të dukshme lehtësuese kohën e gjatë që ka kaluar pas vitit . **Rr.G.** nuk ka pasur dënime paraprake dhe ka qenë qytetar i mirë para kryerjes së veprës penale dhe pas saj. Si rrethana rënduese Trupi Gjykses gjeti se G.B. ishte i plagosur dhe prandaj person i paaftë. Qendra mjekësore ka qenë strehë e sigurt që është shkelur.

Pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartcekura, Gjykata shqiptoi këtë dënim:

Për veprën Krime Luftë kundër Popullatës Civile në rastin e G.B. , në shkeljet të Nenit 142 dhe 22 LPRSFJ lidhur me Konventën e Gjenevës në kuadër të një periudhe të paraparë me ligj ndërmjet pesë (5) dhe katër dhjetë (40) vjet burgim, dënimin prej:

#### **Dymbëdhjetë (12) vjet burgim.**

Në rastin e të Pandehurit **H.G.** Trupi Gjykses ka gjetur si rrethanë të dukshme lehtësuese kohën e gjatë që ka kaluar pas vitit . **H.G.** nuk ka pasur dënime paraprake dhe ka qenë qytetar i mirë para kryerjes së veprës penale dhe pas saj. Si rrethana rënduese Trupi Gjykses gjeti se G.B. ishte i plagosur dhe prandaj person i paaftë. Qendra mjekësore ka qenë strehë e sigurt që është shkelur.

Pas vlerësimit të kujdesshëm të të gjitha rrethanave të lartcekura, Gjykata shqiptoi këtë dënim:

Për veprën Krime Luftë kundër Popullatës Civile në rastin e G.B. , në shkeljet të Nenit 142 dhe 22 LPRSFJ lidhur me Konventën e Gjenevës në kuadër të një periudhe të paraparë me ligj ndërmjet pesë (5) dhe katër dhjetë (40) vjet burgim, dënimin prej:

<sup>2</sup>Rregullorja e UNMIK-ut 1999/24, 12 Dhjetor 1999; Rregullorja e UNMIK-ut 2000/59 mbi ndryshimin e Rregullorës së UNMIK-ut 1999/24, 27 Tetor 2000.

### Dymbëdhjetë (12) vjet burgim.

Për akuzën Krime Luftë kundër Popullatës Civile në shkelje të Nenit 142 dhe 22 LPRSFJ lidhur me Konventat e Gjenevës sa i përket V.B. , I. dhe M.V. , të Pandehurit S. , Rr. dhe H.G. të gjithë është dashur që në pajtim me Nenin 364.1.3 të KPP të

#### Lirohen.

I Pandehuri **Dr. B.Sh.** është dashur të lirohet nga akuza kundër tij sipas Nenit 364.1.3. KPP.

Koha që të Pandehurit **S.G.** , **Rr.G.** dhe **H.G.** kanë kaluar në arrest shtëpiak dhe paraburgim nga data do t'u llogaritet në dënim, sipas Nenit 50 Paragrafi (1) i LPRSFJ .

### F. SHPENZIMET

Të Pandehurit **S.G.** , **Rr.G.** dhe **H.G.** duhet të kompensojnë nga njëqind e pesëdhjetë (150) Euro si pjesë të shpenzimeve të procedurës penale, ndërsa lirohen nga detyrimi për kompensimin e pjesës tjetër të shpenzimeve sipas Nenit 453 Paragrafët (1) dhe (4) KPP. Sipas Nenit 454 KPP, shpenzimet e procedurës penale lidhur me të Pandehurin **Dr. Sh.** do të paguhet nga burimet buxhetore.

Katja Dominik

Dariusz Sielicki

Anna Adamska-Gallant

Kryetare e Trupit Gjykses

Anëtar i Trupit Gjykses

Anëtare e Trupit Gjykses

John Gayer  
Procesmbajtës

#### **Mjeti Juridik:**

*Personat e autorizuar mund të paraqesin ankesë përmes Gjykatës Themelore të Mitrovicës kundër këtij Aktgjykimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditës nga dita që është pranuar kopja e Aktgjykimimit në përputhje me Nenin 380 të KPP.*